

SHËNIM ORIENTUES

KUADËR PËR MATJEN E QASJES NË DREJTËSI SIDOMOS SFIDAT SPECIFIKE QË HASIN GRATË



Përkthimi është bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



SHËNIM ORIENTUES

KUADËR PËR MATJEN

E QASJES NË DREJTËSI

SIDOMOS SFIDAT

SPECIFIKE QË

HASIN GRATË



**POROSITUR NGA UN WOMEN NË
PARTNERITET ME KËSHILLIN
E EUROPËS KËSHILLI I EUROPËS**

New York, Korrik 2016

Përkthimi është bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



FALËNDERIME

Ky raport ka për autore Teresa Marchiori, Konsulente për Gjininë dhe Drejtësinë.

Falënderime të veçanta i shkojnë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Projektit të Drejtësisë në Botë dhe Zyrës Federale Zviceriane për Barazinë Gjimore për komentet dhe kontributin e tyre të çmuar në këtë raport.

TABELA E PËRMBAJTJES

AKRONIME	6	2.4. Integrimi i gjinisë në treguesit e qasjes në drejtësi – mungesa e disagregimit dhe analiza e të dhënave sensitive gjinore	78
1 HYRJE	7	2.4.1. Afërsia gjeografike dhe mundësia ekonomike	78
1.1. Sfondi	7	2.4.2. E drejta për këshillim ligjor, përfaqësim dhe ndihmë juridike	78
1.1.1. Fokusi te sistemet e drejtësisë	7	2.4.3. Trajnimi gjinor për drejtësinë dhe profesionistët e drejtësisë	78
1.1.2. Qasja në drejtësi	7	2.4.4. Rruga përpara - Ndryshimi i qasjes në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave	78
1.1.3. Matja e qasjes	7		
1.1.4. Specifika e përvojës së grave me drejtësinë	7		
1.2. Një kuadër i ri zhvillimi	8	3 TREGUESIT E PROPOZUAR PËR MATJEN E QASJES NË DREJTËSI SIDOMOS SFIDAT SPECIFIKE QË PREKIN GRATË	80
1.2.1. Agjenda-POST 2015 për zhvillimin e qëndrueshëm: një hapësirë e re për drejtësinë	8	3.1. Qëllimi dhe metodologjia	80
1.2.2. Rekomandim i përgjithshëm i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi	9	3.1.1. Qëllimi	80
1.2.3. Matja e progresit në luftën kundër dhunës ndaj grave	9	3.1.2. Struktura	81
		3.1.3. Matja e drejtësisë jo-shtetërore	81
		3.1.4. Përzgjedhja e treguesve	81
1.3. Qëllimi dhe organizimi i raportit	10	3.2. Paketa e treguesve të propozuar për matjen e qasjes në drejtësi sidomos sfidat specifike që prekin gratë	83
		3.2.1. Mjedis mundësues	83
2 VLERËSIMI I TREGUESVE EKZISTUES MATËS TË QASJES NË DREJTËSI HARTËZIMI DHE ANALIZA	11	3.2.2. Pala e ofertës	85
2.1. Metodologjia	11	3.2.3. Pala e kërkesës	92
2.1.1. Burimet	11		
2.1.2. Identifikimi dhe organizimi i treguesve	12	KUTITË	
2.2. Përshkrimi i treguesve ekzistues matës të qasjes në drejtësi	14	Kutia 1. Treguesit e qasjes në drejtësi të përdorur dhe/ose mbështetur në të dhënat e mbledhura nga qeveritë	75
Tabela 2.1. Treguesit e qasjes në drejtësi	14	Kutia 2. Tendencat dhe boshllëqet në treguesit e përdorur dhe/ose mbështetur në të dhënat e mbledhura nga qeveritë	79
Tabela 2.2. Dhuna me Bazë Gjinore – Treguesit e qasjes në drejtësi	46		
Tabela 2.3. Polici	58	ANEKS: QASJET PREMTUESE PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES NË DREJTËSI PËR GRATË	96
Tabela 2.4. Shërbime shtetërore	64		
Tabela 2.5. Treguesit e qasjes në drejtësi të mbështetur në të dhëna administrative	65	BIBLIOGRAFIA	99
2.3. Boshllëqet në masat ekzistuese të qasjes në drejtësi	77		
2.3.1. Fokusi në palën ofruese dhe treguesit e inputit	77	SHËNIME FUNDORE	101
2.3.2. Nevojat ligjore dhe barrierat ndaj qasjes	77		
2.3.3. Ndërgjegjësimi për të drejtat, zgjidhjet, institucionet dhe edukimi ligjor	77		
2.3.4. Rezultatet e drejtësisë	77		

AKRONIME

CEDAW:	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave
CEPEJ:	Komisioni Europian për Eficencën e Drejtësisë
CEVI:	Komiteti i Ekspertëve të Mekanizmit Zbatues të Konventës Belém do Pará
DEMI:	Defensoría de la Mujer Indígena (Zyra e Ndihmës Juridike për Gratë Indigjene)
DHS:	Sondazhe Demografike dhe Shëndetësore
ECLAC:	Komisioni Europian për Amerikën Latine dhe Karaibet
EIGE:	Instituti Europian për Barazinë Gjinore
FRA:	Agjencia e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore
GLSS:	Sondazhi për Standardet e Jetesës në Ganë
GREVIO:	Grupi i ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)
LSMS:	Anketa e Matjes së Standardit të Nivelit të Jetesës
MESECVI:	Mekanizëm zbatues i Konventës Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave, “Belém do Pará Convention”
OZHM:	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
OJQ:	Organizatë jo-qeveritare
OAS:	Organizata e Shteteve Amerikane
OEA:	Organización de los Estados Americanos
OECD:	Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim
PEKKA:	Pemberdaayan Perempuan Kepala Keluarga (Fuqizimi i Familje me Kryefamiljare Gra)
OZHQ-të:	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SIEH:	Sistema Integrado de Encuestas de Hogares (Sistemi i Integruar i Anketës së njësisë ekonomike familjare)
SIGI:	Institucionet Sociale dhe Indeksi Gjinor
UNDP:	Programi i OKB-së për Zhvillim
UNODC:	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNROLI:	Treguesit e OKB-së për Shtetin e së Drejtës
USAID:	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
WBL:	Gratë, Biznesi dhe Drejtësia
WJP:	Projekti i Drejtësisë në Botë

HYRJE

1.1.

Sfondi

1.1.1. Fokusi mbi sistemet e drejtësisë

Vitet e fundit, komuniteti ndërkombëtar ka rritur fokusin e tij në përmirësimin e sistemeve të drejtësisë brenda vendeve. Forcimi i kornizave ligjore dhe institucioneve të drejtësisë për të luftuar korrupsionin, për të tërhequr investime, për të trajtuar pabarazinë, për të përmirësuar sigurinë dhe për të zgjeruar aksesin e njerëzve në burime ka marrë hov mes qeverive dhe aktorëve ndërkombëtarë. Vëmendja dhe ndërhyrjet e shtuara në këtë sektor kanë sjellë nevojën për krijimin e mjeteve më të mira për vlerësimin e sistemeve të drejtësisë, me qëllim identifikimin e elementëve kryesorë që ndikojnë në funksionimin e makinerisë së drejtësisë. Grupet e ekspertëve dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë kanë kontribuar në një tërësi të konsiderueshme treguesish që vlerësojnë aspekte të ndryshme të sistemeve të drejtësisë. Treguesit ekzistues përdoren aktualisht nga qeveritë, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të vlerësuar sistemet e drejtësisë dhe për të monitoruar progresin drejt synimeve dhe objektivave specifike, si dhe për të vendosur standarde me të cilat mund të matet respektimi i sundimit të ligjit nga qeveritë dhe të dokumentohen tendencata.

1.1.2. Qasja në drejtësi

Në një kontekst të interesit dhe angazhimit të rritur për reformën dhe forcimin e sistemeve të drejtësisë, aftësia e qytetarëve për të hyrë në institucionet e drejtësisë me qëllim adresimin e ankesave të tyre dhe për të zgjidhur konfliktet është parë si një element thelbësor i zhvillimit, të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Në përkufizimin e gjerë mbi të cilin mbështetet ky raport, qasja në drejtësi përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për të bërë të mundur që qytetarët të kërkojnë zgjidhje për ankesat e tyre dhe që të drejtat e tyre të respektohen. Këto elemente përfshijnë një kuadër ligjor që u jep të drejta gjithëpërfshirëse dhe të barabarta të gjithë qytetarëve në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; ndërgjegjësimi i gjerë ligjor dhe njohuria e

popullsisë; mundësimi i këshillave dhe përfaqësimit ligjor të përballueshëm dhe cilësor; mundësimi i mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që janë të aksesueshme, të përballueshme, në kohë, efektive, efikase, të paanshme, pa korrupsion dhe të besueshme, dhe që ndjekin rregulla dhe procese në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; dhe mundësimi i mekanizmave efikase dhe të paanshëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore.¹ Në qasjen e bazuar në të drejta që mbështet këtë raport, qasja në drejtësi mund të referohet gjithashtu si aftësia e “bartësit të detyrimit” (d.m.th. institucioneve të cilave u është besuar autoriteti dhe detyra për të dhënë drejtësi) për të ofruar akses dhe aftësia e “mbajtësve të të drejtave” (d.m.th., individëve dhe subjekteve që kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin drejtësi) për të ushtruar të drejtat e tyre nëpërmjet qasjes në shërbimet e drejtësisë.²

1.1.3. Matja e qasjes

Qasja në drejtësi ka qenë fokusi i studimeve dhe vlerësimeve të shumta, dhe treguesit janë hartuar dhe zbatuar për të gjurmuar progresin dhe për të mbledhur të dhëna mbi elementët që pengojnë dhe lehtësojnë aftësinë e qytetarëve për qasje në sistemet e drejtësisë. Numri i madh i treguesve përfshin “masat e performancës institucionale dhe përputhshmërinë me normat ndërkombëtare, anketat e përvojës dhe perceptimit të përdoruesve, indekset me bazë të gjerë dhe “paketat” e treguesve që synojnë të integrojnë koncepte të ndryshme” (Berg dhe Desai 2013). Treguesit mund të kapin elementë të palës ofruese të drejtësisë (d.m.th., institucionet dhe individët që ofrojnë shërbime të drejtësisë) ose palës kërkuese të drejtësisë (d.m.th., përdoruesit e destinuar të këtyre shërbimeve).

1.1.4. Specifika e përvojës së grave me drejtësinë

E drejta e grave dhe burrave për barazi para ligjit dhe të drejta të barabarta për mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve është sanksionuar në një sërë instrumentesh ndërkombëtare, që sanksionojnë qasjen në drejtësi si një e drejtë universale e njeriut dhe garantojnë matjen e tij në mënyra që kapin specifikat gjinore të përvojave të individëve.³

Në këtë kontekst, një sërë studimesh dhe raportesh nga aktorë ndërkombëtarë⁴ – duke përfshirë Kombet e Bashkuara, Bankën Botërore, Këshillin e Europës dhe Komitetin e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave – kanë nxjerrë në pah sfidat unike me të cilat përballen gratë që kërkojnë të kenë qasje në drejtësi dhe rëndësinë e vlerësimit të tyre. Të gjithë kanë treguar mungesën e të dhënave që matin qasjen e grave në drejtësi dhe që dokumentojnë ndërhyrje të suksesshme si çështje që kërkon vëmendje të menjëhershme dhe të fokusuar. Në fakt, pavarësisht nga rëndësia e shtuar e qasjes në drejtësi në ligjëratën e zhvillimit, specifika e përvojës së grave me ligjin dhe drejtësinë – si përdoruese ashtu edhe si ofruese – mbetet akoma pak e dokumentuar me të dhëna statistike.⁵ Megjithatë, pranohet gjerësisht fakti që është më e vështirë për gratë, mesatarisht, të kenë akses në hapësirat institucionale për të negociuar dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për të marrë një zgjidhje të drejtë të ankesave të tyre. Ndërsa shumë nga barrierat që kufizojnë qasjen në drejtësi rrjedhin nga faktorë të tjerë përveç gjinisë (si varfëria, analfabetizmi, mungesa e njohurive të gjuhëve zyrtare dhe mungesa e njohurive dhe ndërgjegjësimit ligjor), ato kanë tendencë të prekin më shumë gratë se burrat. Në fakt, një kombinim i barrierave sociale dhe institucionale e përkeqëson vështirësinë që hasin gratë për të përdorur institucionet e drejtësisë – kuintili i të ardhurave, nivelet e arsimit dhe grupet etnike – duke krijuar barriera më të larta në hyrje dhe pushim në shkallë të lartë, dhe duke i bërë gratë më të cenueshme gjatë procesit gjyqësor. Përveç kësaj, barrierat si ligjet diskriminuese dhe stigmatizimi social janë specifike gjinore, duke rritur në mënyrë dramatike hendekun e qasjes.

1.2.

Kuadër i ri zhvillimi

1.2.1. Agjenda post-2015 për zhvillimin e qëndrueshëm: një hapësirë e re për drejtësinë

Më 25 SHTATOR 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën 70/1, "Transformimi i botës tonë: Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm". Rezoluta përmban 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe 169 synimet e dakordësuara, nëpërmjet të cilave shtetet anëtare angazhohen për zbatimin e një kuadri të ri për zhvillimin e qëndrueshëm deri në vitin 2030. Kuadri i ri, i cili bazohet në mësimet e nxjerra në dekadën e kaluar, duke

përfshirë zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), bazohet në pranimin e faktit që vetëm shoqëritë paqësore dhe të drejta mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, dhe që një sistem drejtësie funksional dhe i aksesueshëm është element thelbësor i zhvillimit në vetvete dhe një faktor mundësues për realizimin e qëllimeve të tjera për zhvillim. Arritja e drejtësisë për të gjithë del si prioritet në agjendën e re të zhvillimit dhe qasja në drejtësi ka marrë një rëndësi të re. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave janë gjithashtu në pararojë me preambulën e Rezolutës 70/1 sipas të cilës "[17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe 169 synimet] synojnë të realizojnë të drejtat e njeriut të të gjithëve dhe të arrijnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave".⁶

OZHQ-të 16,5 dhe 17 janë veçanërisht të rëndësishme për këtë studim. Objektivi 16 përcakton angazhimin për të "[p]romovuar shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë dhe për të ndërtuar institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet". Në veçanti, Objektivi 16.3 fokusohet në promovimin e "sundimit të ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar" dhe në sigurimin e "të drejtave të barabarta për drejtësinë për të gjithë". Objektivat 16.5, 16.6 dhe 16.7 synojnë të rrisin efikasitetin, transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përfaqësimin e institucioneve, duke vendosur si objektiva të tyre "uljen e korrupsionit" (16.5), zhvillimin e "institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet" (16.6) dhe krijimin e "vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet" (16.7). Një element kyç i aftësisë së individëve për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për qasje në drejtësi është sigurimi i identitetit ligjor, duke përfshirë regjistrimin e lindjes, siç përcaktohet nga synimi 16.9. Në fund, Objektivi 16.b fokusohet në promovimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave jodiskriminuese për zhvillim të qëndrueshëm. Objektivi 5⁷ përfshin synimet që trajtojnë aspektet e barazisë gjinore dhe fuqizimit të vajzave dhe grave që janë të lidhura qartë me qasjen në drejtësi, si p.sh. dhënia fund e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe vajzave kudo (synimi 5.1); eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave (5.2); sigurimi i pjesëmarrjes së grave dhe mundësisë të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, jetën ekonomike dhe publike (5.5); ndërmarrja e reformave për t'u dhënë grave të drejta të barabarta për burime ekonomike, pronë, shërbime financiare, trashëgimi dhe burime natyrore

(5.a); dhe, në fund, miratimi dhe fuqizimi i politikave të shëndosha dhe legjislationit të ekzekutueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet (5.c).

Krijimi i treguesve kuptimplotë, të matshëm dhe teknikisht të qëndrueshëm për të gjurmuar progresin drejt çdo qëllimi dhe objektivit theksohet gjithashtu në kuadrin e ri, siç është mbledhja e “bashkësive të të dhënave të besueshme dhe në kohë, [përmes] burimeve të reja dhe jotradicionale të të dhënave” (OKB 2014), ndërsa “disagregimi më i gjerë dhe sistematik i të dhënave” theksohet si themelor për të zbuluar pabarazitë dhe për t’i bërë ndërhyrjet e bazuara në të dhëna vërtet reaguese ndaj nevojave të atyre që janë më të cenuar (Paneli i Nivelit të Lartë të Personave të Shquar në Agjendën 2013 të Zhvillimit PAS 2015). Objektivi 17, që përcakton mënyrat e zbatimit të agjendës, i përfshin këto elemente në synimin 17.18, i cili kërkon rritjen e kapacitetit të vendeve në zhvillim “për të rritur ndjeshëm disponueshmërinë e të dhënave me cilësi të lartë, në kohë dhe të besueshme, të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës ... dhe karakteristikave të tjera të rëndësishme në kontekstet kombëtare”. Në fund, synimi 17.19 angazhon komunitetin ndërkombëtar të “bazohet në nismat ekzistuese për të kryer matjet e progresit për zhvillimin e qëndrueshëm”.

1.2.2. Rekomandim i përgjithshëm i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi

Në vijim të rëndësisë së fituar rishtazi të qasjes në drejtësi për të gjithë në agjendën e re të zhvillimit, rekomandimi i përgjithshëm i Komitetit CEDAW Nr.33 fokusohet në qasjen e grave në drejtësi. Në rekomandim, komiteti identifikon gjashtë komponentë thelbësorë të qasjes në drejtësi (Komiteti CEDAW 2015: 5-6):

- dhënia e drejtësisë, që është aftësia e papenguar e grave për qasje në drejtësi dhe për të kërkuar të drejtat e tyre sipas CEDAW;
- dhënia e mundësisë, që nënkupton ekzistencën e gjykatave dhe organeve kuazi-gjyqësore në të gjithë territorin e vendit, duke përfshirë zonat rurale dhe të largëta;
- aksesueshmëria, që kërkon që të gjitha sistemet e drejtësisë të jenë të sigurta, të përbalueshme, të arritshme fizikisht nga gratë dhe të përshtatura me dhe të duhura për nevojat e grave;

- cilësia e mirë, e cila përfshin elementë të tillë si kompetenca, efikasiteti, pavarësia, paanshmëria dhe respektimi i afateve kohore, ndër të tjera;
- sigurimi i mjeteve juridike të qëndrueshme dhe kuptimplota;
- llogaridhënia e sistemit (eve) të drejtësisë.

Veçanërisht, mbledhja e të dhënave dhe përdorimi i treguesve janë ndër masat që Komiteti CEDAW rekomandon për të përmirësuar qasjen e grave në drejtësi. Në veçanti, për të përmirësuar llogaridhënien, shtetet inkurajohen të mbledhin të dhëna mbi aspektet e qasjes në drejtësi, duke përfshirë, inter alia, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe avokatëve; numrin dhe shpërndarjen gjinore të profesionistëve që punojnë në organet gjyqësore dhe kuazi-gjyqësore; dhe natyrën, numrin, gjatësinë dhe rezultatin e rasteve të paraqitura dhe të trajtuara nga organet gjyqësore dhe kuazi-gjyqësore – të gjitha të ndara sipas gjinisë së kërkuarit. Rekomandohen gjithashtu studime cilësore dhe analiza kritike gjinore për të mësuar më shumë rreth atyre faktorëve që pengojnë ose promovojnë qasjen e grave në drejtësi dhe për të informuar politikën që synojnë përmirësimin e llogaridhënies së sistemeve të drejtësisë (ibid: 10). Në fund, krijimi i treguesve që matin qasjen e grave në drejtësi është theksuar në rekomandimet e Komitetit për përmirësimin e cilësisë së drejtësisë (ibid: 8).

1.2.3. Matja e progresit në luftën kundër dhunës ndaj grave

Mjetet e vlerësimit dhe matjes janë zhvilluar gjithashtu për të gjurmuar progresin në reagimin e shtetit për dhunën ndaj grave. Organizata e Shteteve Amerikane (OAS) ka finalizuar së fundmi, nëpërmjet Mekanizmit zbatues të Konventës Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkrimin dhe Çrrenjosjen e Dhunës ndaj Grave, “Konventën Belém do Pará” (MESECVI), një paketë treguesish për t’u monitoruar progresin e shteteve anëtare në lidhje me zbatimin e konventës. Paketa përfshin tregues strukturorë, të cilët vlerësojnë ekzistencën e kuadrit kombëtar ligjor dhe institucional të përshtatshëm për të zbatuar dhe për të mbrojtur të drejtat e grave në përputhje me konventën, duke u fokusuar veçanërisht “në ligjet e brendshme që kanë të bëjnë me të drejtën për të jetuar një jetë pa dhunë dhe në mekanizmat institucionale që promovojnë dhe zbatojnë ato ligje” (OAS 2013:

7); treguesit e procesit, të cilët matin masën në të cilën politikat, planet dhe strategjitë nxisin realizimin e të drejtave specifike të parashikuara në konventë; dhe treguesit e rezultateve, të cilët "kërkojnë të masin ndikimin aktual të strategjive, programeve dhe ndërhyrjeve të shtetit në lidhje me garantitë e të drejtave të grave" (ibid.). Kjo paketë treguesish do të përdoret nga shtetet palë në Konventën Belém do Pará për të monitoruar progresin në zbatimin e saj dhe për ta raportuar atë.

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2014 dhe përcakton procedurat e monitorimit përmes të cilave vlerësohen ecuria e shteteve palë në realizimin e të drejtave të ofruara nga konventa dhe zbatimin e dispozitave të saj. Për këtë qëllim është ngritur një trupë ekspertësh të pavarur, Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). Konventa krijon detyrime për shtetet palë që të kërkojnë dhe të mbledhin të dhëna për shtetet palë. Në veçanti, neni 11 kërkon nga shtetet palë të "mbledhin të dhëna statistikore përkatëse të ndara në intervale të rregullta për rastet e të gjitha formave të dhunës që mbulon objekti i kësaj Konvente" dhe "të përipiqen të kryejnë anketa të bazuara në popullatë në intervale të rregullta për të vlerësuar epërsinë dhe tendencat e në të gjitha format e dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente" (Këshilli i Europës, 2016). Përveç kësaj, shtetet duhet t'i raportojnë rregullisht GREVIO-s për progresin e tyre në zbatimin e konventës, duke ofruar të dhëna të mbledhura në fushat që mbulon konventa.⁸

1.3.

Qëllimi dhe organizimi i raportit

Në këtë kontekst, ky raport synon të avancojë ligjëratën aktuale për Treguesit e qasjes në drejtësi duke hartëzuar përpjekjet ekzistuese për mbledhjen e të dhënave dhe instrumentet matëse dhe duke propozuar një paketë treguesish që qeveritë, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare mund të miratojnë për të vlerësuar shkallën në të cilën sistemet e drejtësisë aksesohen nga të gjithë, me vëmendje të veçantë ndaj barrierave të qasjes me të cilat përballen gratë.

Pjesa e mbetur e raportit është e strukturuar në dy pjesë shtesë. Pjesa II i kushtohet përcaktimit dhe analizës së treguesve ekzistues që matin qasjen në drejtësi. Seksioni i parë shpjegon metodologjinë e ndjekur në realizimin e përcaktimit dhe përpilimit të treguesve. Seksioni 2 përfshin tabelat që përmbajnë Treguesit e qasjes në drejtësi, të nxjerra nga një kampion i burimeve. Seksioni 3 analizon boshllëqet në treguesit ekzistues, duke theksuar fushat e qasjes në drejtësi që mund të eksplorojnë më tej, dhe Seksioni 4 fokusohet në qasjet që mund të ndihmojnë në identifikimin më të mirë të barrierave të grave për të njohur dhe adresuar nevojat e tyre.

Në fund, Pjesa III paraqet një propozim për një paketë me tregues që mund të kapin aspektet e qasjes në drejtësi që prekin veçanërisht gratë, boshllëqet gjinore në qasjen në drejtësi dhe barrierat që hasin gratë të cilat kërkojnë të kenë qasje në drejtësi. Seksioni 1 i kësaj pjese shpjegon Metodologjinë e përdorur për përzgjedhjen dhe paraqitjen e treguesve, dhe Seksioni 2 ofron një listë të treguesve të propozuar si dhe logjikën pas përzgjedhjes së tyre.

VLERËSIMI I TREGUESVE EKZISTUES MATËS TË QASJES NË DREJTËSI: HARTËZIMI DHE ANALIZA

2.1.

Metodologjia

2.1.1. Burimet

Përcaktimi i treguesve ekzistues të përdorur për të vlerësuar qasjen në drejtësi është bërë për të vlerësuar statusin aktual të qasjes në masat e drejtësisë duke mësuar se cilët tregues përdoren aktualisht nga organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile dhe qeveritë.

Është kryer një studim literature i burimeve ekzistuese të treguesve të qasjes në drejtësi. Studimi mbuloi një sërë burimesh të ndryshme duke përfshirë: grupe treguesish globale të përdorur për të vlerësuar respektimin e shteteve për sundimin e ligjit, konkurrencën e biznesit, barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave fuqizimi; anketën kombëtare të njëjësive ekonomive familjare dhe sondazhin e opinionit publik; treguesit e përdorur nga zyrat kombëtare të statistikave, zyrat statistikore të gjykatave dhe konventat ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh numrin e madh të treguesve ekzistues të qasjes në drejtësi dhe pamundësinë për t'i numëruar të gjithë, ushtrimi synon të ofrojë një kampion të treguesve ekzistues dhe jo një listë gjithëpërfshirëse. Këto burime u përzgjedhën me synimin për të ofruar një kampion të balancuar të treguesve të qasjes në drejtësi të përdorur nga organizatat shumëpalëshe (globale dhe rajonale), organizatat e shoqërisë civile dhe qeveritë kombëtare. Kampioni, duke përfshirë treguesit e përdorur dhe/ose të zhvilluar nga qeveritë kombëtare (qofshin apo jo zyrat e tyre kombëtare statistikore), duhet të përfaqësojë diversitetin rajonal. Nisur nga qëllimi i këtij raporti, përmbajtja e të cilit është e hapur për inputin dhe vlerësimin nga partnerët, burime shtesë

mund të shtohen për përcaktimin dhe inkurajohen sugjerimet përkatëse nga partnerët dhe palët e interesuara.⁹

Burimet e mëposhtme janë përdorur për të kryer përcaktimin:

- Afrobarometër;
- Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- Sondazhe Demografike dhe Shëndetësore (DHS);
- Komisioni Europian për Amerikën Latine dhe Karaibet (ECLAC) dhe Divizionet e tij të Bazave të të Dhënave dhe Publikimeve Statistikore, CEPALSTAT;
- Komisioni Europian për Eficencën e Drejtësisë (CEPEJ–Këshilli i Europës)
- Instituti Europian për Parandalimin dhe Kontrollin e Krimin, pranë OKB-së (HEUNI) – Përmbledhja europiane e statistikave të krimin dhe drejtësisë penale, BOTIMI I 5TË;
- Mekanizmi zbatues i Konventës Belém do Pará (MESECVI) - “Treguesit e progresit për matjen e zbatimit të Konventës Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Çrrenjosjen e Dhunë ndaj Grave, ‘Belém do Pará Convention’, miratuar nga Komiteti i Ekspertëve (CEVI) më 21 MAJ 2013”;
- Agjencia e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore (FRA) - “Sondazh për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Europë”;
- Integriteti global - Raporti i Integritetit Global

- Qeveria e Mongolisë - "Arritja e Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Raporti i Pestë i Progresit Kombëtar"(2013);
- Instituti Kombëtar i Statistikave - Annuaire Statistique du Cameroun (2013);
- Qendra Kombëtare për qasje në drejtësi - Indeksi i drejtësisë;
- Zyra Kombëtare Statistike e Kenias Fakte dhe shifra 2014;
- Banka Botërore - Anketa e Matjes së Standardit të Nivelit të Jetesës;
- Agjencia Qendrore Statistike, Etiopi – 2011/12 Anketa Socio-ekonomike rurale;
- Shërbimi statistikor i Ganës - Anketa për Standardet e Jetesës në Ganë Raundi 6 (2014);
- Instituti Kombëtar për Statistika, Guatemala - Anketa Kombëtare e Guatemalës për Kushtet e Jetesës (2000);
- Drejtoria Kombëtare e Statistikave, Anketa për Kushtet e Jetesës në Timor-Leste (2007) dhe Anketa e Zgjeruar për Kushtet e Jetesës në Timor-Leste (2008);
- Agjencia Shtetërore për Statistika, Instituti i Statistikave i Republikës Srpska, Instituti i Statistikave i Federatës së BH – Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2004 (Panel i Valës 4);
- Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (OECD) - Institucionet Sociale dhe Indeksi Gjiner (SIGI);
- Treguesit e OKB-së për Shtetin e së Drejtës (UNROLI);
- Statistikat Gjimore OKB;
- Treguesit Gjimore të Bankës Botërore;
- Treguesit e Projektit të Drejtësisë në Botë (WJP);
- Gratë, Biznesi dhe Drejtësia (WBL).

2.1.2. Identifikimi dhe organizimi i treguesve

Vlerësimi i burimeve të përfshira në kampion u krye për të identifikuar treguesit që adresojnë qasjen në drejtësi, duke përfshirë ata që fokusohen në çështjet e lidhura me gjininë dhe pengesat specifike për qasjen e grave. Treguesit e identifikuar në këtë mënyrë janë përpiluar në Tabelat 2.1. deri në 2.5.

Tabela 2.1.paraqet Treguesit e qasjes në drejtësi, të grupuar në mënyrë tematike rreth 15 dimensioneve që pasqyrojnë shpalosjen e zinxhirit të drejtësisë dhe pasqyrojnë kuptimin e gjerë të qasjes në drejtësi të supozuar në këtë ushtrim – që shtrihet nga ekzistenca e të drejtave dhe privilegjeve thelbësore në aksesin fizik, ekonomik dhe intelektual të gjykatave, në proceset e drejta dhe efektive, llogaridhënie, transparencë dhe mungesë të korrupsionit në institucionet gjyqësore.

Dimensionet janë:

- të drejtat dhe privilegjet;
- ndihma dhe përfaqësimi ligjor;
- ndërgjegjësimi ligjor dhe njohuria/opinionet dhe perceptimet e së drejtës dhe sistemeve të drejtësisë;
- çështjet kryesore të gjykueshme të përjetuara nga qytetarët/masat e marra/rezultatet/përfshirja në drejtësinë penale;
- besimi/kënaqësia në institucionet e drejtësisë;
- qasja në institucioneve të drejtësisë;
- procedurat;
- mekanizmat e ankimimit;
- pavarësia e gjyqësorit;
- korrupsioni;
- transparenca dhe llogaridhënia;
- ekzekutimi i vendimeve të gjykatës;
- kapaciteti i sistemit të drejtësisë;
- gjykatat e posaçme dhe procedurat; zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve.

Tabelat japin informacionin e mëposhtëm në lidhje me treguesit:

- subjekti që ka zhvilluar/përdor treguesin: organizata ose qeveria që ka krijuar treguesin dhe/ose e përdor atë për të vlerësuar qasjen në sistemin e drejtësisë;
- burimet e të dhënave: të dhënat mbi të cilat mbështetet secili tregues, duke përfshirë të dhënat objektive (si të dhënat administrative dhe në terren dhe vlerësimi i dokumentit) dhe të dhënat subjektive (si anketat e njësive ekonomike familjare dhe sondazhi i

opinionit publik, intervistat e ekspertëve dhe anketat e ekspertëve);

- sektori i sektorit të drejtësisë që mbulohet nga treguesi: nëse treguesi mbulon gjykatat dhe të drejtat kushtetuese, civile, penale, administrative apo të gjithë sistemin e drejtësisë;
- nëse treguesi përshkruan dhe/ose vlerëson inputet, outputet ose rezultatet e sistemeve të drejtësisë: ku inputet janë elementë që mundësojnë funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe ofrimin prej tij të shërbimeve (si burimet njerëzore dhe materiale, ligjet, rregulloret, procedurat, mekanizmat dhe institucionet); outpute janë rezultatet dhe shërbimet e menjëhershme të ofruara nga sistemi i drejtësisë (si p.sh. numri i çështjeve të zgjidhura nga gjykatat, ose numri i klientëve që kanë përfituar nga shërbimet e ndihmës juridike); dhe rezultatet janë rezultati përfundimtar i shërbimeve të drejtësisë, që gjithashtu ndikon në qëndrimet dhe aftësinë e përdoruesve për të hyrë në sistem (siç është besimi i publikut në sistemin e drejtësisë dhe kostot e

përgjithshme të proceseve të drejtësisë); nëse treguesi përshkruan dhe/ose vlerëson një element të palës ofertuese ose palës kërkuese të sistemit të drejtësisë: ku “pala kërkuese” i referohet përfituesve të destinuar të shërbimeve të drejtësisë ose, në një qasje të bazuar në të drejtat për qasje në drejtësi, i referohet bartësit të të drejtave (që është tërësia e qytetarëve, pavarësisht nëse janë apo jo në kontakt me sistemin e drejtësisë); dhe “pala ofruese” e drejtësisë i referohet ligjeve dhe rregulloreve, mekanizmave dhe institucioneve që përbëjnë makinerinë e drejtësisë.

Tabela 2.2. përfshin Treguesit e qasjes në drejtësi në lidhje me dhunën me bazë gjinore; Tabela 2.3. fokusohet te policia; dhe Tabela 2.4. te shërbimet shtetërore. Në fund, Tabela 2.5. rendit ata tregues, mes atyre që janë përfshirë në tabelat e mësipërme, që mbështeten në mbledhjen e të dhënave administrative.

2.2.

Përcaktimi i treguesve ekzistues matës të qasjes në drejtësi

Kodi i ngjyrës: Treguesit e fokusuar në elemente gjinore të qasjes në drejtësi
 Treguesit e bazuar në të dhëna administrative

TABELA 2.1.
Treguesit e qasjes në drejtësi

Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
TË DREJTA DHE PRIVILEGJE					
Traktatet Ndërkombëtare janë pjesë e kuadrit ligjor kombëtar					
Përputhshmëria e të drejtës dhe rregulloreve të brendshme me traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe konventat	Qeveria e Mongolisë - "Arritja e Objektiveve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Raporti i Pestë i Progresit Kombëtar". Të dhënat e analizuar nga Zyra Kombëtare e Statistikave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik – Monitorimi dhe Vlerësimi i Varfërisë dhe OZHM-ve Sistemi Kombëtar me Zyrën Kombëtare të Statistikave (Qeveria e Mongolisë, Raport Progresi për OZHM)	Vlerësim eksperti	Kushtetuese/ civile/penale/ administrative	Inputi	Pala ofruese
Për më shumë tregues në këtë kategori, shihni Tabelën 2.2. (treguesit e dhunës me bazë gjinore)					
Të drejta kushtetuese					
A ka në kushtetutë ndonjë klauzolë për mosdiskriminimin?	Gratë, Biznesi dhe Drejtësia (WBL)	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
A ka në kushtetutë ndonjë klauzolë për mosdiskriminimin dhe a e përmend shprehimisht gjininë?	WBL	Anketë eksperti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
A garanton kushtetuta barazi përpara ligjit?	WBL	Vlerësim dokument	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese

Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
A njihet e drejta zakonore si burim i vlefshëm i të drejtës sipas kushtetutës?	WBL	Anketë eksperti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
Nëse e drejta zakonore është burim i vlefshëm i së drejtës, a konsiderohet i pavlefshëm nëse shkel dispozitat kushtetuese për mosdiskriminimin ose barazinë?	WBL	Vlerësim dokumenti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
A njihet e drejta personale si burim i vlefshëm i të drejtës sipas kushtetutës?	WBL	Anketë eksperti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
Nëse e drejta personale është burim i vlefshëm i së drejtës, a konsiderohet i pavlefshëm nëse shkel dispozitat kushtetuese për mosdiskriminimin ose barazinë?	WBL	Anketë eksperti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
Ligje dhe rregullore kombëtare					
<i>Identitet ligjor/shtetësi</i>					
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të aplikojë për kartë identiteti kombëtare njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të aplikojë për pasaportë njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar t'i japë shtetësinë fëmijëve të saj njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese/civile	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar t'i japë shtetësinë bashkëshortit të saj jo shtetas njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese/civile	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të jetë "kryefamiljare" njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese/civile	Inputi	Pala ofruese
Martesa - në ligj					
Mosha e ligjshme për martesë - Nëse gratë dhe burrat kanë të njëjtën moshë të ligjshme minimale për martesë	OECD SIGI	Profil Shteti ¹⁰	Civile	Inputi	Pala ofruese
Përgjegjësia prindërore në martesë - Nëse gratë dhe burrat kanë të njëjtën të drejtë për të qenë kujdestarë ligjorë të një fëmije gjatë martesës	OECD SIGI	Profil Shteti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Përgjegjësia prindërore në divorc - Nëse gratë dhe burrat kanë të njëjtën të drejtë për të qenë kujdestarë ligjorë dhe për të ushtruar të drejta kujdestarie mbi fëmijën pas divorcit	OECD SIGI	Profil Shteti	Civile	Inputi	Pala ofruese

Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
A kërkohet me ligj që gratë e martuara t'i binden burrave të tyre?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A kanë përgjegjësi të përbashkët çiftet e martuara për të ndarë financiarisht shpenzimet e familjes?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Cili është regjimi pasuror martesor standard?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Kush e administron ligjërisht pasurinë gjatë martesës?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Nëse bashkëshorti administron ligjërisht pasurinë gjatë martesës, a kërkohet pëlqimi i bashkëshortes për transaksione të mëdha?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A ekzistojnë dispozita të veçanta (transaksione në lidhje me) banesën familjare?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A parashikon ligji vlerësimin e kontributeve jo-monetare gjatë martesës	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Martesa – në praktikë					
Martesa e parakohshme Përqindja e grave të martuara ndërmjet grup-moshës 15 deri në 19 vjeç	OECD SIGI	Burimet dytësore të të dhënave sasiore	Civile	Rezultati	-
Prona - në ligj					
Sigurimi i të drejtës mbi tokën - Nëse ligjet garantojnë të drejta të barabarta dhe të sigurta për gratë dhe burrat për përdorimin, kontrollin dhe pronësinë e tokës	OECD SIGI	Profil Shteti SIGI	Civile	Inputi	Pala ofruese
Sigurimi i të drejtës për pasuri jo tokë - Nëse ligjet garantojnë të drejta të barabarta dhe të sigurta për gratë dhe burrat për përdorimin, kontrollin dhe pronësinë e pasurive jo tokë	OECD SIGI	Profil Shteti SIGI	Civile	Inputi	Pala ofruese
A kanë burrat dhe gratë e martuar/të pamartuar të drejta pronësie të barabarta ndaj pronës?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Prona – në praktikë					
Pronësia e banesës ose shtëpie tjetër/e tokës bujqësore ose jo-bujqësore, vetë ose bashkërisht me dikë tjetër	DHS	Anketa e njëjësive ekonomike familjare - të dhëna të disagreguara sipas gjinisë	Civile	-	Pala kërkuese

- Treguesit e fokusuar në elemente gjinore të qasjes në drejtësi
- Treguesit e bazuar në të dhëna administrative

Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
Ekzistenca e titullit të pronësisë për çdo shtëpi/ tokë bujqësore ose jo bujqësore në pronësi	DHS	Anketa e njëjësive ekonomike familjare - të dhëna të disagreguara sipas gjinisë	Civile	-	Pala kërkuese
Nëse emri i të anketuarit është në titullin e pronësisë	DHS	Anketa e njëjësive ekonomike familjare - të dhëna të disagreguara sipas gjinisë	Civile	-	
Trashëgimia					
Të drejtat e trashëgimisë së grave vejusha - Nëse gratë vejusha dhe burrat vejan kanë të drejta të barabarta trashëgimie	OECD SIGI	Profil Shteti SIGI	Civile	Inputi	Pala ofruese
Të drejta trashëgimie të vajzave -Nëse vajzat dhe djemtë kanë të drejta të barabarta trashëgimie	OECD SIGI	Profil Shteti SIGI	Civile	Inputi	Pala ofruese
A kanë vajzat dhe djemtë të drejta të barabarta trashëgimie për pronën?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A kanë bashkëshortët/bashkëshortet mbijetues/e, gra dhe burra, të drejta të barabarta trashëgimie?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
E drejta për kredi					
E drejta për shërbime financiare - Nëse burrat dhe gratë kanë të njëjtat të drejta për shërbime financiare	OECD SIGI	Profil Shteti SIGI	Civile	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e pa martuar të hapë një llogari bankare njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
E drejta tregtare					
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të nënshkruajë një kontratë njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të regjistrojë një biznes njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Liria e lëvizjes					
E drejta për hapësirën publike - Nëse ligjet vendosin kufizime ndaj lirisë së grave për lëvizje dhe të drejtën e hapësirës publike, siç është aftësia e kufizuar për të zgjedhur vendin e tyre të qëndrimit, për të vizituar familjet dhe miqtë e tyre ose për të aplikuar për pasaportë	OECD SIGI	Profil Shteti SIGI	Civile	Inputi	Pala ofruese

Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të dalë jashtë banesës së saj njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të udhëtojë jashtë shtetit njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të zgjedhë ku të jetojë njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
E drejta për punë dhe privilegje të tjera të lidhura					
A mundet një grua e martuar/e pa martuar të fillojë punë ose të ushtrojë një zanat apo profesion njësoj si një burrë?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Përfitime prindërore ¹¹ Dalja në pension dhe masa e pensionit Orët e punës dhe kufizimet e industrisë Mbrojtja e vendit të punës	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile	Inputi	Pala ofruese
Juridiksioni dhe rregulla procedurale					
A i njeh ligji gjykatat zakonore?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese/civile/ penale	Inputi	Pala ofruese
A i njeh ligji gjykatat personale?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Kushtetuese/civile/ penale	Inputi	Pala ofruese
A ka dëshmia e një gruaje të njëjtën vlerë prove në gjykatë si ajo e një burri?	WBL	Anketë eksperti/ vlerësim dokumenti	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
A ka kompensim për viktimat e krimit? Për cilat lloj veprash penale? Çfarë përmban kompensimi?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
Ofrimi i ndihmës ligjore/përfaqësimit/ndihmës juridike					
Mundësia që një i varfër të marrë këshilla ligjore nga një avokat, jurist ose qendër të ndihmës juridike	WJP	Pyetësori i të anketuarit të kualifikuar	Civile/administrative	Outputi	Pala ofruese
Sa gjasa ka që një i dyshuar i ndaluar që kërkon të drejtën për këshillim ligjor të marrë këshillimin e duhur ligjor nga një avokat të caktuar nga shteti gjatë arrestit në polici/paraburgimit/gjykimit?	WJP	Pyetësori i të anketuarit të kualifikuar	Penale	Outputi	Pala ofruese
Sa i rëndë është problemi i numrit të pamjaftueshëm të avokatëve të ofruar nga shteti ose pro bono për të pandehurit e varfër?	WJP	Pyetësori i të anketuarit të kualifikuar	Penale	Ndikimi	Pala kërkuese
Ofrimi i ndihmës ligjore falas për të pandehurit indigjenë	UNROLI (fokusi mbi drejtësinë penale)	Anketë eksperti	Penale	Outputi	Pala ofruese

- Treguesit e fokusuar në elemente gjinore të qasjes në drejtësi
- Treguesit e bazuar në të dhëna administrative



Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
Ofrimi i ndihmës ligjore për të miturit në konflikt me ligjin	UNROLI	Anketë eksperti	Penale	Outputi	Pala ofruese
Në ligj, shteti ofron këshillim ligjor në çështje penale për të pandehurit që nuk kanë mundësi ta përballojnë	Integriteti global	Intervistim eksperti	Penale	Inputi	Pala ofruese
Në praktikë, shteti ofron këshillimin ligjor të duhur në çështje penale për të pandehurit që nuk kanë mundësi ta përballojnë	Integriteti global	Intervistim eksperti	Penale	Inputi	Pala ofruese
Nëse të anketuarit (që kanë dalë para gjykatës pesë vitet e fundit) nuk mund të merrnin këshillim ligjor	Afrobarometër	Anketa e njësisë ekonomike familjare	Civile/penale	Rezultati	Pala ofruese
Numri i avokatëve që ofrojnë shërbime për qytetarët që nuk kanë mundësi të paguajnë për to	Qeveria e Mongolisë, Progres Raporti për OZHM	Të dhëna administrative	Kushtetuese/ civile/penale/ administrative	Inputi	Pala ofruese
Numri i avokatëve për 1000 njerëz të varfër (matur në çdo shtet të SHBA-ve dhe krahasuar me numrin e avokatëve për 10000 njerëz që nuk janë të varfër).	Indeksi i drejtësisë	Studim literature/ intervistim eksperti	Civile/penale/ administrative	Inputi	Pala ofruese
A zbatohet ndihma juridike për: <ul style="list-style-type: none"> • përfaqësimin në gjykatë? • Këshillim ligjor? Në: • çështje penale? • çështje të ndryshme nga çështjet penale? 	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
A përfshin ndihma juridike mbulimin e ose përjashtimin nga tarifatat gjyqësore?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
A mund të jepet ndihmë juridike për tarifatat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (p.sh tarifa për përmbaresin)?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
A mund të jepet ndihmë juridike për kosto të tjera (p.sh tarifa për këshilltarë ose ekspertë teknikë, kostot e profesionistëve të tjerë të ligjit (noterë) ose kostot e udhëtimit)?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
Numri i çështjeve të referuara në gjykatë për të cilat është dhënë ndihmë juridike	CEPEJ	Raport i shtetit/ të dhëna administrative	Civile/penale	Outputi	Pala ofruese
Numri i çështjeve që nuk çohen në gjykatë (çështje pa palë kundërshtare ose çështje të sjella në gjykatë siç janë ato që zgjidhen me konsultim ligjor ose zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve, ZAM) për të cilat është ofruar ndihmë juridike	CEPEJ	Raport i shtetit/ të dhëna administrative	Civile	Outputi	Pala ofruese

Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
Në çështje penale, a mundet që personat/viktimat e akuzuar që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare të ndihmohen nga avokat falas (ose të financohen nga buxheti i shtetit) dhe a janë njerëzit të lirë të zgjedhin avokatin brenda kuadrit të sistemit të ndihmës juridike?	CEPEJ	Raport i shtetit	Penale	Inputi	Pala ofruese
A bëhet vlerësimi i të ardhurave dhe pasurive për t'i dhënë kërkuetit ndihmë juridike	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
Në çështje të ndryshme nga ato kriminale, a është e mundur që të refuzohet ndihma juridike për mungesë të themelit të çështjes (p.sh për padi të parëndësishme ose për shkak se nuk ka mundësi për sukses) dhe kush e merr vendimin për të dhënë ose refuzuar ndihmën juridike?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
Numri total i avokatëve praktikantë në vend, përfshirë këshilltarët ligjorë që nuk mund të përfaqësojnë klientët e tyre në gjykatë	CEPEJ	Raport i shtetit/ të dhëna administrative	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
A kanë avokatët monopol për përfaqësimin ligjor?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
Si organizohet profesioni i avokatit (p.sh përmes një dhome avokatie)?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
A ekziston trajnimi fillestar specifik dhe/ose provimi për të filluar profesionin e avokatit?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
A ekziston një sistem i përgjithshëm i detyrueshëm për avokatët që kërkon trajnimin profesional në detyrë?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
A lidhet specializimi në disa fusha ligjore me trajnim specifik, nivele kualifikimi, diploma specifike ose autorizime specifike?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
Rregullimi i tarifave të avokatëve	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
Mbështetje për palët ndërgjyqëse të vetë-përfaqësuar	Indeksi i drejtësisë	Studim literature/ intervistim eksperti	Civile/penale/ administrative	Inputi	Pala ofruese
Përgjegjshmëria e avokatëve					
Rregullimi i standardeve të cilësisë	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese
Procedura disiplinore	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile	Inputi	Pala ofruese

- Treguesit e fokusuar në elemente gjinore të qasjes në drejtësi
- Treguesit e bazuar në të dhëna administrative



Objektivi/treguesi	Zhvilluar/përgatitur nga	Burimi i të dhënave	E drejta kushtetuese/ penale civile	Inputi/outputi/ rezultati/ ndikimi/procesi	Pala kërkuese/ ofruese
Cilësia e ndihmës ligjore/përfaqësimit					
Cilësia e përfaqësimit ligjor përgjithësisht në dispozicion të të pandehurve në procese penale	UNROLI	Anketë ekspert	Penale	Inputi	Pala ofruese
Sa i rëndë është problemi i paaftësisë së avokatëve të siguruar nga shteti ose pro bono për të pandehurit e varfër?	WJP	Pyetësor i të anketuarit të kualifikuar	Penale	Ndikimi	Pala kërkuese
Kosto e ndihmës ligjore/përfaqësimit					
Sa do të kërkonte një avokat për të përfaqësuar një klient?	WJP	Pyetësor i të anketuarit të kualifikuar	Civile	Inputi	Pala ofruese
A është i kushtueshëm procesi?	WJP	Pyetësor për mbarë popullatën	Civile	Rezultati	Pala kërkuese
NDËRGJEGJËSIMI LIGJOR DHE NJOHURIA/OPINIONE DHE PERCEPTIME TË SË DREJTËS DHE SISTEMEVE TË DREJTËSISË					
A kanë njerëzit dijeni për masat në dispozicion?	WJP	Nuk matet	Civile	-	Pala kërkuese
A ka faqe zyrtare interneti/portale (p.sh ministria e drejtësisë) përmes të cilave mbarë publiku mund të njihet falas me tekstet ligjore (p.sh kode, ligje, rregullore), praktikën gjyqësore të gjykatave më të larta dhe dokumente të tjera (p.sh formate që mund të shkarkohen, regjistrim online)?	CEPEJ	Raport i shtetit	Civile/penale	Inputi	Pala ofruese
Njohuri për ndonjë mekanizëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas qarqeve dhe vendndodhjes	Sondazhi për Standardet e Jetesës në Ganë	Anketa e njësisë ekonomike familjare	Civile/penale	-	Pala kërkuese
Njohuri/perceptim nëse një titull pronësie është pretendimi më i fuqishëm në ndjekje të një pretendimi toke në sistemin e gjykatës	Anketa e Zgjeruar për Kushtet e Jetesës në Timor-Leste (2008)	Anketa e njësisë ekonomike familjare	Civile	-	
Sfidat që hasin gratë për qasjen në drejtësi rrallëherë dalin në dritë nga instrumentet ekzistuese të vlerësimit dhe matjes. Ndërkohë që shumë tregues të qasjes në drejtësi trajtojnë fushat ku gratë janë në disfavor kundrejt burrave, mungesa e të dhënave të ndara dhe moskombinimi i grupeve të ndryshme të të dhënave (p.sh. distanca mesatare e gjykatave nga përdoruesit së bashku me ofrimin e mjeteve të transportit për gratë) i bëjnë më të paqarta situatat e qasjes së pabarabartë. Disa fusha të qasjes në drejtësi janë veçanërisht të rëndësishme për gratë dhe duhet të jenë objekt i analizës me ndjeshmëri gjinore.

2.4.1. Afërsia gjeografike dhe mundësia ekonomike

Shpërndarja gjeografike e gjykatave është një element thelbësor i qasjes në drejtësi dhe për ta matur atë aktorë të ndryshëm 24 kanë hartuar dhe përdorin një sërë treguesish. Distanca e gjykatave dhe koha e udhëtimit prekin qartazi si burrat ashtu edhe gratë – në shkallë të ndryshme, në varësi të faktit nëse ata jetojnë në zona urbane apo rurale ose nëse kanë mundësi për mjetet e transportit dhe situatës së tyre ekonomike. Megjithatë, gratë janë shpesh në disfavor krahasuar me burrat, dhe kjo vërshtirë se nxirret nga treguesit ekzistues. Ka gjasa që gratë të kenë më pak mundësi për mjetet e transportit dhe mjetet ekonomike për të paguar udhëtimet e tyre; ka më shumë gjasa të kenë lëvizshmëri të kufizuar dhe janë veçanërisht të prekura nga mungesa e kohës. Mungesa e institucioneve të kujdesit për fëmijët lehtësisht të arritshme nga gratë pranë vendbanimit të tyre ose e ndërtesave të gjykatave është gjithashtu një element i rëndësishëm që ndikon në aftësinë e grave për qasje në drejtësi. Për më tepër, gjykatat e specializuara që merren me çështje të një rëndësie të veçantë për gratë, si gjykatat e familjes ose gjykatat e padive të vogla, si dhe njësitë e specializuara të policisë dhe prokurorisë (si ato që merren me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje) zakonisht ndodhen në zonat urbane, shpesh në kryeqytetin e rrethit ose të provincës. Kostoja e procedurave, po ashtu, mund të përbëjë një pengesë më të madhe ndaj qasjes për

gratë krahasuar me burrat, duke pasur parasysh shpërndarjen e pabarabartë të burimeve të familjes dhe të ardhurat mesatare më të ulëta të familjeve me kryefamiljare gra në krahasim me familjet me kryefamiljarë burra.

2.4.2. E drejta për këshillim ligjor, përfaqësim dhe ndihmë juridike

Po kështu, ofrimi i profesionistëve ligjorë që ofrojnë këshillim dhe përfaqësim të përballueshëm në proceset gjyqësore është thelbësor për të garantuar qasjen në drejtësi për të gjithë. Megjithatë, gratë ka të ngjarë të përfitojnë më shumë nga ofrimi i ndihmës ligjore dhe, nga ana tjetër, të vuajnë në mënyrë disproporcionale nga mungesa e saj. Shkalla më e ulët e edukimit dhe njohurisë së gjuhëve zyrtare krahasuar me burrat, aksesit i kufizuar në media dhe, shpesh, në jetën publike, ka gjasa të përkthehet në ndërgjegjësim më të ulët për të drejtat, procedurat dhe mekanizmat në dispozicion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ndërkohë që ka tregues që matin disponueshmërinë dhe cilësinë e ndihmës ligjore dhe përfaqësimit dhe të shërbimeve të ndihmës juridike, mungojnë masa dhe të dhëna që matin mënyrën se si gratë dhe burrat i përjetojnë këto shërbime dhe mënyrat specifike të ndikimit të tyre nga mungesa e këtyre shërbimeve.

2.4.3. Trajnimi gjinor për drejtësinë dhe profesionistët e drejtësisë

Matja e trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët rrallëherë përfshihet në paketën e treguesve që matin kapacitetin e sistemit të drejtësisë. Ndër tetë burimet e shqyrtuara, vetëm raporti i CEPEJ-it e mbulon këtë fushë. Madje, akoma më pak vëmendje i kushtohet trajnimit specifik gjinor – i fokusuar në forcimin e kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë për të identifikuar nevojat dhe sfidat specifike gjinore në procesin e drejtësisë dhe për t'iu përgjigjur atyre në mënyrën e duhur, si edhe për të forcuar njohuritë e tyre për ligjet, rregulloret dhe procedurat specifike për adresimin e fushave të tilla si dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje. Vetëm një nga treguesit e CEPEJ-it për trajnimin ka të bëjë me aspektet gjinore të drejtësisë: ai mat nëse të gjitha prokuroritë kanë prokurorë të trajnuar posaçërisht për dhunën në familje dhe dhunën seksuale.

2.4.4. Rruga përpara - Ndryshimi i qasjes në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave

Siç u përmend, me përjashtim të treguesve për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave, vetëm një numër i vogël i treguesve të listuar në tabelat e mësipërme trajton sfidat e grave ndaj qasjes në drejtësi. Këta tregues grupohen rreth fushave specifike, duke përfshirë ekzistencën e një kuadri ligjor që ofron të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, dhe përfaqësim të barabartë në profesionet ligjore dhe gjyqësore. Megjithatë, treguesit e përgjithshëm që vlerësojnë aspektet e qasjes në drejtësi që prekin si burrat ashtu edhe gratë mund të japin informacion të vlefshëm për dallimet gjinore në mundësi, nëse të dhënat mbi të cilat ato mbështeten ndahen sistematikisht dhe analizohen së bashku me të dhënat demografike që nxjerrin në pah boshllëqet gjinore në fusha specifike.

Në fakt, në mënyrë që një sistem drejtësie të ofrojë mundësi për të gjithë, ai duhet të ketë aftësinë të zbulojë dhe për t'i përgjigjet nevojave dhe sfidave të të gjithë

përdoruesve. Një hap thelbësor në këtë drejtim është përdorimi i instrumenteve matëse që mund të kapin natyrën e përbërë të palës kërkuese të drejtësisë dhe të matin mënyrat e ndryshme në të cilat gratë dhe burrat e përjetojnë drejtësinë, dhe pengesat e ndryshme me të cilat përballen. Për shembull, për të kapur shkallën dhe mënyrat specifike se si gratë dhe burrat preken nga pengesat ndaj afërsisë gjeografike dhe mundësisë ekonomike, të dhënat duhet të ndahen sistematikisht dhe të dhënat e perceptimit duhet të mblidhen për të plotësuar të dhënat administrative dhe në terren për vendndodhjen e gjykatave dhe kostot e procedurave. Gjithashtu, analiza e të dhënave duhet të përfshijë një korrelacion me të dhënat e ndara për shpërndarjen e burimeve brenda familjes, mundësimin e mjeteve të transportit, rolet gjinore në shoqëri dhe në familje, shkallën e edukimit ligjor dhe nivelet e ndërgjegjësimit ligjor.

KUTIA 2.

Tendencat dhe boshllëqet në treguesit e përdorur dhe/ose mbështetur në të dhënat e mbledhura nga shtetet

Treguesit e destinuar për përdorim nga shtetet dhe të dhënat që mblidhen si rezultat i tyre, ndryshojnë për nga natyra dhe shërbejnë për qëllime të ndryshme. Disa prej tyre, siç janë treguesit e CEPEJ, ata që mblidhen nga organet administrative ose statistikore brenda sektorit të drejtësisë dhe, në një farë mase, treguesit MESECVI, synojnë të vlerësojnë aspektet strukturore dhe funksionale të makinerisë së drejtësisë – të tilla si aftësia reaguese, eficienta, efektiviteti dhe llogaridhënia. Të tjerë, siç janë treguesit e përfshirë në disa nga anketat e standardeve të jetesës, kapin aspekte të palës kërkuese të qasjes në drejtësi, duke përfshirë çështjet kryesore të gjyqësorë, preferencën për organin gjyqësor dhe besimin tek institucionet e drejtësisë. Kështu pra, nuk mungojnë shembujt të përpjekjeve të shteteve për të vlerësuar dhe mbledhur informacion rreth sistemeve të tyre të drejtësisë. Megjithatë, nevojiten disa vëzhgime. Së pari, treguesit e CEPEJ-it, për shembull, ftojnë shtetet të raportojnë për probleme të caktuara, por qeveritë nuk janë të detyruara të mbledhin të dhënat e kërkuara dhe mund të tregojnë që këto të dhëna mungojnë. Së dyti, nevojiten më shumë kërkime për të vlerësuar shkallën në të cilën vendet mbledhin të dhëna për qasjen në drejtësi dhe nëse të gjitha vendet mbledhin të paktën disa të dhëna. Për sa i përket identifikimit të boshllëqeve në treguesit e përdorur dhe të dhënave të mbledhura nga shtetet, kjo është detyrë që duhet të ndërmerret rast pas rasti. Në fakt, zgjedhja e shteteve për të matur disa aspekte të aksesit në drejtësi do të varet nga prioritetet kombëtare të identifikuar, të cilat mund të jenë ose jo në përputhje me tendencat globale. Nga ana tjetër, një paketë fleksibël treguesish, si kjo që propozohet në këtë raport, mund të jetë e dobishme për t'u ofruar shteteve një sërë matjesh për të vlerësuar elementët bazë të palës ofruese dhe palës kërkuese që duhet të jenë të pranishëm që një sistem drejtësie të jetë i aksesueshëm nga të gjithë.

TREGUESIT E PROPOZUAR PËR MATJEN E QASJES NË DREJTËSI SIDOMOS SFIDAT SPECIFIKE QË HASIN GRATË

Treguesit japin një pasqyrë të statusit dhe progresit të një dukurie sociale, ekonomike ose tjetër nëpërmjet një vlerësimi të elementeve të tij përbërës, ose të zëvendësuesve të tyre. Qasja në drejtësi është një fenomen kompleks që, në kuptimin e gjerë që mbështet këtë ushtrim, përfshin ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në ligje dhe rregullore, ndërgjegjësimin e publikut për këto të drejta dhe aftësinë për të ushtruar dhe kërkuar këto të drejta përmes mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që janë të drejta, efikase dhe të përgjegjshme.

Hapësira që ka hapur dialogu për një agjendë të re post-2015 zhvillimi për matjen e drejtësisë, duke përfshirë qasjen në drejtësi, ofron një mundësi unike për të zgjeruar treguesit e propozuar në një kontekst të tillë dhe për të krijuar një grup gjithëpërfshirës treguesish që matin qasjen, ofrimin, pranueshmërinë dhe cilësinë e drejtësisë dhe sistemeve që mbështesin dhënien e saj. Gjithashtu, rekomandimi i përgjithshëm i CEDAW mbi qasjen e grave në drejtësi dhe praktikën e mira që lindin nga terreni (shih Aneksin 1) ofron një trampolinë të vlefshme për hartimin dhe zbatimin e treguesve që mund të matin sfidat specifike me të cilat përballen gratë që kërkojnë të kenë qasje në drejtësi. Ajo që vijon është një kornizë për krijimin e një pakete me këta tregues.

3.1.

Qëllimi dhe metodologjia

3.1.1. Qëllimi

Bazuar në hartëzimin dhe analizimin e treguesve, më poshtë jepet një listë treguesish që synojnë të vlerësojnë shkallën e aksesueshmërisë të një sistemi drejtësie, me fokus të veçantë në barrierat e qasjes së grave. Qëllimi kryesor që drejton formulimin e këtyre treguesve është

t'u ofrojë qeverive, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare mjete për:

- drejtimin e reformës ligjore, politikë-bërjen dhe ndërhyrje për të përmirësuar qasjen e grave dhe burrave në drejtësi;
- vlerësimin e boshllëqeve ekzistuese në ofertën dhe kërkesën për shërbime të drejtësisë që ndikojnë në qasjen e grave dhe burrave në drejtësi;
- lehtësimin e monitorimit dhe raportimit mbi progresin në përmirësimin e qasjes së grave dhe burrave në drejtësi dhe zbatimin e të drejtave dhe privilegjeve të grave;
- mundësimin e krahasimit të tendencave në qasjen e grave dhe burrave në drejtësi, me kalimin e kohës dhe brenda dhe ndërmjet vendeve;
- nxitjen e mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë për fushat që ndikojnë drejtpërdrejt ose indirekt në qasjen e grave dhe burrave në drejtësi;
- rritjen e ndërgjegjësimit për statusin e qasjes së grave dhe burrave në drejtësi dhe për barrierat përkatëse.

3.1.2. Struktura

Treguesit e propozuar organizohen rreth tre dimensioneve: 1) mjedisi mundësues, që mbulon kuadrin ligjor që përcakton të drejtat dhe privilegjet, rregulloret dhe masat mbrojtëse që përcaktojnë hapësirën brenda së cilës qytetarët dhe shteti mund të negociojnë qasjen në drejtësi dhe rezultatet e drejtësisë; 2) pala ofruese e drejtësisë, përfshirë elementët që përbëjnë makinerinë e drejtësisë, si institucionet dhe burimet njerëzore, thelbësore për ofrimin e shërbimeve të drejtësisë; dhe 3) pala kërkuese e drejtësisë, duke u fokusuar në ato elemente që bëjnë të mundur që qytetarët të kërkojnë mjete juridike përmes sistemit të drejtësisë.

Përgjatë dhe brenda këtyre dimensioneve, treguesit janë grupuar rreth elementeve kryesore të qasjes në drejtësi që pasqyrojnë hapat përgjatë zinxhirit të drejtësisë, duke përfshirë: mbrojtjen e të drejtave të parashikuara në ligje dhe rregullore; shfaqjen e ankesave ose shkeljeve; mjetet që u nevojiten individëve për të hyrë dhe për të përdorur sistemin e drejtësisë; dhe mekanizmat dhe masat mbrojtëse për të garantuar që proceset dhe rezultatet të jenë të pranueshme për palët e përfshira. Këto elemente përfshijnë:

- kuadrin ligjor;
- nevojat e drejtësisë;
- ndërgjegjësimin ligjor, ofrimin e këshillimit ligjor dhe përfaqësimit (ndihmë juridike);
- qasjen në gjykatë;
- procesin e drejtë dhe rezultatit;
- besimin në sistemin e drejtësisë.

Më poshtë jepet një diskutim më i shtjelluar i secilit element.

Këto janë kritere që përdoren në përzgjedhjen e treguesve të propozuar:

- kuadrin ligjor;
- nevojat e drejtësisë;
- ndërgjegjësimin ligjor, ofrimin e këshillimit ligjor dhe përfaqësimit (ndihmë juridike);
- qasjen në gjykatë;
- procesin e drejtë dhe rezultatit;
- besimin në sistemin e drejtësisë.

3.1.3. Matja e drejtësisë jo-shtetërore

Sistemet e drejtësisë jo-shtetërore – që janë sisteme ligjore zakonore dhe fetare që ekzistojnë krahas sistemit juridik dhe gjyqësor të shtetit, legjitimiteti i të cilave qëndron në zakonet dhe traditat ose që kanë një konotacion fetar – luajnë një rol thelbësor si mekanizma për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në disa shtete të karakterizuara nga sisteme juridike pluraliste. Shpesh ato janë zgjedhja e preferuar – ose e vetmja – për gratë që kërkojnë drejtësi. Megjithëse ne e njohim një rol të tillë të sistemeve të drejtësisë jo-shtetërore, ky studim fokusohet në sistemet e drejtësisë shtetërore dhe treguesit që kemi formuluar përfshijnë vetëm disa matje që adresojnë shprehimisht sistemet e drejtësisë jo-shtetërore (të tilla si ato që kërkojnë të matin besimin në sistemet e drejtësisë dhe kohëzgjatjen e procedurave), ndërsa të tjerat mund të aplikohen si për sistemet e drejtësisë shtetërore ashtu edhe për ato jo-shtetërore të drejtësisë. Këto kanë për qëllim të japin shembuj të masave të mundshme të elementeve të sistemeve të drejtësisë jo-shtetërore që mund të kapen lehtësisht nga treguesit standardë. Zgjedhja për të mos përfshirë drejtësinë jo-shtetërore në fokusin e punës sonë është pjesërisht për shkak të faktit se matja e aspekteve të sistemeve juridike jo-shtetërore përmes metodave sasiore është sfiduese dhe matjet e marra mund të jenë shumë keqorientuese nëse nuk kontekstualizohen siç duhet. Megjithatë, ne e pranojmë se për të pasur një pasqyrë gjithëpërfshirëse të sistemeve normative dhe të drejtësisë në dispozicion të grave dhe burrave në një vend, duhet të përgatiten tregues që synojnë sisteme të tilla jo-shtetërore. Duke pasur parasysh karakterin shumë idiosinkratik dhe lokal të sistemeve juridike zakonore dhe fetare, tregues të tillë hartohen më së miri nëpërmjet një procesi konsultativ të udhëhequr nga vendi, duke përfshirë palët e interesuara nga sistemet e drejtësisë shtetërore dhe jo-shtetërore.

3.1.4. Përzgjedhja e treguesve

Treguesit e mëposhtëm u përzgjedhën me synimin për t'iu përgjigjur nevojave institucionale të UN Women, që ka porositur këtë studim dhe Këshillit të Europës. Brenda një kuadri të tillë, përzgjedhjen tonë e kanë udhëhequr parimet e mëposhtme. Ndërsa ne besojmë se treguesit nuk duhet të mbingarkojnë shtetet me kërkesa sforcuese për mbledhjen e të dhënave, ne jemi të mendimit se treguesit duhet të luajnë gjithashtu një rol në katalizimin e përpjekjeve të reja për mbledhjen e të dhënave dhe

forcimin e kapaciteteve, si pjesë e përpjekjes për një “revolucion të të dhënave”. Shkurtimisht, treguesit duhet të jenë realistë, por edhe me natyrë frymëzuese. Paketa e propozuar përpiqet të arrijë një ekuilibër të tillë. Për aq sa është e mundur, çdo dimension përfshin tregues që mbështeten në të dhëna objektive/administrative dhe të dhëna subjektive/perceptuese, në mënyrë që të jepet një pasqyrë sa më shteruese e statusit të qasjes në drejtësi. Në fund, disa nga masat e propozuara janë nxjerrë nga treguesit ekzistues të përfshirë në hartëzimin bashkangjitur; disa janë huazuar nga propozimet e bëra nga pjesëmarrësit në dialogun për agjendën e zhvillimit pas 2015, ndërsa të tjerët kërkojnë të plotësojnë boshllëqet e identifikuara në mjetet ekzistuese të matjes.

Lista e mëposhtme synon të japë një kuadër për matjen e shkallës në të cilën gratë dhe burrat kanë qasje të barabartë në sistemin e drejtësisë. Brenda çdo dimension, palët e interesuara mund të zgjedhin, ose të formulojnë sërish, tregues specifikë sipas nevojave dhe rrethanave të tyre. Për të siguruar një vlerësim të plotë të qasjes së grave në drejtësi në të gjithë zinxhirin e drejtësisë, rekomandohet që të ndiqet një qasje gjithëpërfshirëse duke zgjedhur të paktën një tregues për secilin dimension.

3.2.

Paketa e treguesve të propozuar për matjen e qasjes në drejtësi sidomos sfidat që hasin gratë

3.2.1. Mjedis mundësues

i. Kuadri ligjor

Gjykatat dhe proceset gjyqësore efikase nuk kanë kuptim nëse qytetarëve nuk u jepen të drejta të sigurta që ata mund të pretendojnë dhe të zbatojnë përmes këtyre gjykatave dhe proceseve. Është kuadri ligjor ai që përcakton se cilat çështje janë të gjykueshme dhe që mund të zgjidhen me mjete ligjore. Ekzistenca e një kuadri ligjor që u jep të drejta të barabarta qytetarëve është themeli i një sistemi drejtësie të arritshëm nga të gjithë. Ligjet e

pabarabarta, ose ligjet pa perspektivë gjinore që u japin formalisht të drejta të barabarta grave dhe burrave, por praktikisht penalizojnë gratë, dëmtojnë aftësinë e grave për të marrë rezultate të drejta drejtësie. Ligjet që përcaktojnë zotësinë juridike dhe legjitimitimin, të drejtat pronësore dhe trashëgimore, martesën dhe divorcin janë ndër ato që kanë më shumë gjasa të vijojnë diskriminimin dhe të pengojnë fuqizimin e grave.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Masa në të cilën ligjet kombëtare janë në përputhje me traktatet ndërkombëtare detyruese për të drejtat e njeriut dhe të grave	Intervistim ekspert/ vlerësim dokumenti ligjor	MESECVI
Masa në të cilën praktika gjyqësore e organeve ndërkombëtare dhe rajonale e të drejtave të njeriut është në përputhje me traktatet ndërkombëtare detyruese për të drejtat e njeriut dhe të grave	Intervistim ekspert/ vlerësim i praktikës gjyqësore	Ky tregues synon të plotësojë të mëparshmin duke monitoruar organin e vendimeve gjyqësore për të drejtat e njeriut, që, ashtu si praktika gjyqësore, përbën një burim shtesë të së drejtës
Masa në të cilën ligjet kombëtare janë në përputhje me traktatet ndërkombëtare detyruese për dhunën ndaj grave	Intervistim ekspert/ vlerësim dokumenti ligjor	MESECVI
Masa në të cilën praktika gjyqësore e organeve ndërkombëtare dhe rajonale e të drejtave të njeriut është në përputhje me traktatet ndërkombëtare detyruese për dhunën ndaj grave	Intervistim ekspert/ vlerësim i dokumentacionit të praktikës gjyqësore	Ky tregues synon të plotësojë të mëparshmin duke monitoruar organin e vendimeve gjyqësore për të drejtat dhe privilegjet që lindin nga traktatet ndërkombëtare për dhunën ndaj grave
Masa në të cilën legjislacioni kombëtar ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe indirekt në fushat e mëposhtme (palët e interesuara të zgjedhin një ose më shumë nga sa më poshtë sipas nevojave dhe përparësive të tyre): 1) zotësia juridike/legjitimimi 2) të drejta të pronës 3) të drejta trashëgimie 4) të drejta në martesë 5) të drejta për t'u divorcuar dhe për të marrë kujdestarinë e fëmijëve 6) zotësia për të hapur një llogari bankare 7) të drejta për të fituar, ndryshuar, mbajtur ose kaluar shtetësinë 8) të drejta për edukim 9) të drejta për punësim	Intervistim ekspert/ vlerësim dokumenti ligjor	Fushat e trajtuara nga CEDAW dhe indeksi WBL

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
<p>Nëse ligjet kombëtare i japin grave dhe burrave trajtim të njëjtë në fushat e mëposhtme (palët e interesuara - të zgjedhin një ose më shumë nga sa më poshtë sipas nevojave dhe përparësive të tyre):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) zotësia juridike/legjitimimi 2) të drejta të pronës 3) të drejta trashëgimie 4) të drejta në martesë 5) të drejta për t'u divorcuar dhe për të marrë kujdestarinë e fëmijëve 6) zotësia për të hapur një llogari bankare 7) të drejta për të fituar, ndryshuar, mbajtur ose kaluar shtetësinë e tyre 8) të drejta për edukim 9) të drejta për punësim 	<p>Intervistim eksperti/ vlerësim dokumenti ligjor</p>	<p>Fushat e trajtuara nga CEDAW dhe indeksi WBL</p>
<p>Ekzistenca e ligjeve që kriminalizojnë (palët e interesuara të zgjedhin një ose më shumë nga sa më poshtë sipas nevojave dhe përparësive të tyre):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) dhunën psikologjike dhe kriminale 2) përndjekjen 3) dhunën seksuale përfshirë përdhunimin (edhe kur kryhet nga bashkëshorti/Ja/Partneri/Ja) 4) martesën me detyrim 5) gjymtimin e organeve gjentiale të femrave 6) abortin dhe sterilizimin me detyrim 7) ngacmimin seksual dhe tentativën dhe dhënien e ndihmës për kryerjen e këtyre veprave penale 8) forma të seksualizuara të korrupsionit 	<p>Vlerësim dokumenti ligjor</p>	<p>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) , nenet 33-41</p> <p>Një tregues i ngjashëm përdoret nga MESECVI UNODC ka propozuar një tregues (pa specifikuar veprat penale që duhet të përfshihen në ligj) në kontekstin e dialogut për agjendën post-2015 PËR ZHVILLIMIN</p>
<p>Legjitimimi në gjykatë i njihet subjekteve juridike (p.sh OJQ-të, sindikatat e punës)</p>	<p>Intervistim eksperti/ studim literature</p>	<p>Mundësia që u jepet subjekteve juridike për të sjellë çështje në gjykatë është aset i çmuar për të bërë të efektshëm qasjen e grave në drejtësi. Në fakt, në disa çështje, përmes proceseve gjyqësore strategjike, OJQ-të kanë arritur të krijojnë përfitime domethënëse për të drejtat e grave. Gjithashtu, organizata flamurtare të të drejtave të grave mund të marrin përsipër çështjet që prekin njerëzit që, për arsye të ndryshme, mund të mos jenë në gjendje ose të gatshëm të ndjekin çështjet personalisht, ose të bashkojnë forcat me personat e prekur, duke i shtuar peshë (në aspektin e mjeteve ekonomike dhe vizibilitetit) çështjes.</p>
<p>Ekzistenca e ligjeve që parashikojnë dënime jo penale, siç janë urdhrat e mbrojtjes, në çështje të dhunës me bazë gjinore, përdhunimit dhe dhunës në familje.</p>	<p>Intervistim eksperti/ studim literature</p>	<p>Vetë dënimet penale nuk mund të japin një përgjigje të mjaftueshme në çështje të dhunës ndaj grave, sidomos përdhunimit. Në disa çështje, për shembull, gratë varen nga bashkëshorti i tyre për jetesën e tyre dhe të fëmijëve të tyre, kështu që sanksionet siç janë urdhrat e mbrojtjes, mund të përbëjnë një mjet ligjor më të përshtatshëm se një dënim me burgim.</p>

3.2.2. Pala ofruese

i. Kapaciteti

Matja e kapacitetit do të thotë vlerësim i aftësisë së sistemit të drejtësisë për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve për drejtësi. Kapaciteti i referohet një fenomeni kompleks, i cili përfshin të gjithë zinxhirin e drejtësisë. Të dyja aspektet objektive (burimet njerëzore, trajnimi) dhe subjektive (kënaqësia e përdoruesit, opinioni i ekspertëve) të kapacitetit janë relevante dhe matja e të dyjave mundëson një vlerësim të balancuar. Treguesit e propozuar më poshtë kapin elementë të vendosur në skajet e kundërta të zinxhirit të drejtësisë. Matja e inputeve, siç janë numri i gjyqtarëve dhe magistratëve për 100 000 banorë, jep të dhëna të qarta për kapacitetin aktual të sistemit (relevanca e treguesit bazohet në supozimin se personeli i duhur, edhe pse jo i mjaftueshëm,

është i nevojshëm për të siguruar ofrimin e shërbimeve të drejtësisë civile, administrative dhe penale). Ndarja e të dhënave sipas gjinisë lejon që të vlerësohet diversiteti dhe përfaqësimi i sistemit të drejtësisë – një element thelbësor i kapacitetit të sistemit – pasi “pjesëmarrja e grave në gjyqësor ...është e rëndësishme në mënyrë që sistemi i drejtësisë të pasqyrojë shoqërinë që i shërben. Gratë gjyqtare ... mund të promovojnë forcimin e shtetit të së drejtës duke kontribuar në një gjyqësor të paanshëm ... si dhe nëpërmjet rolit të tyre në zbatimin e ligjeve (përfshirë qasjen në drejtësi për gratë dhe vajzat)” (UNODC 2013: 59).

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Numri i gjyqtarëve/magjistratëve për 100 000 banorë, sipas seksit	Të dhëna administrative	Tregues të ngjashëm: Shërbimi Statistikor i Ganës CEPEJ
Numri i gjyqtarëve, sipas gjinisë, që gjykojnë në: • gjykatat e shkallës së parë • gjykatat e shkallës së dytë • gjykatat e larta	Të dhëna administrative	Rekomandim i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi (2015: 10). Shënim: ekzistojnë tregues të ngjashëm që janë të formular në mënyrë specifike gjinore, të cilat matin në mënyrë të shprehur pjesëmarrjen e grave në profesion gjyqësor. Këta tregues janë: % e gjyqtarëve që janë gra (UNROLI, UNODC, Statistika Gjinore të Bankës Botërore, MESECVI); numri i gjyqtarëve në gjykatën kushtetuese; dhe numri i gjyqtarëve në gjykatën kushtetuese që janë gra dhe nëse kryetarja e gjykatës është grua (WBL).
Numri i çështjeve të depozituara për gjyqtar, të ndara sipas gjinisë dhe llojit të çështjes		Ky tregues synon të masë kapacitetin aktual të një sistemi drejtësie, të shprehur me ngarkesën e gjyqtarëve. Disagregimi i të dhënave sipas gjinisë dhe llojit të çështjes mund të theksojë tendencat e mundshme në numrin dhe tipologjinë e çështjeve të caktuara gjyqtarëve burra dhe gra.
Përqindja e stafit administrativ të gjykatës (jo-gjyqtarë) që janë gra, të ndarë sipas pozicionit	Të dhëna administrative	CEPEJ; Rekomandim i përgjithshëm i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi
Ofrimi i trajnimit të detyrueshëm fillestar/të vazhdueshëm për stafin në fushën e drejtësisë (polici/gjykata/prokurorë) për çështje gjinore	Anketë eksperti/ Intervista/të dhëna terreni	Të përfshira në Rekomandim i përgjithshëm të Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi Tregues të ngjashëm: MESECVI CEPEJ
Koliko je ozbiljan problem nedostatak kapaciteta pravosudnog osoblja (policija/sudije/tužioc)?	Anketë eksperti/sondazh i stafit gjyqësor	Slični indikator: WJP
Përqindja e (numrit total të personave të kualifikueshëm) nëpunësve civilë dhe publikë që kanë hyrë në procese trajnimi, ndërgjegjësimi dhe trajnimi për çështje të dhunës ndaj grave	Të dhëna administrative	MESECVI Komiteti i Ekspertëve (CEVI)

ii. Ofrimi dhe cilësia e ndihmës juridike

Ofrimi i këshillave dhe ndihmës ligjore falas ose të përballueshme për çështjet penale dhe civile është thelbësor për të nxitur qasjen e barabartë në drejtësi për të gjithë. Ndërhyrjet e fokusuara në dhënien e këshillave dhe ndihmës ligjore kanë treguar një ndikim pozitiv në qasjen e grave në drejtësi, në situata që variojnë nga denoncimi

i përdhunimit ose abuzimi për marrjen e certifikatave të lindjes, martesës ose divorcit. Ndihma dhe përfaqësimi ligjor falas ose i përballueshëm mund të ofrohet nga qeveria, por shpesh plotësohet nga avokatë privatë që punojnë pro bono dhe nga organizata të shoqërisë civile nëpërmjet avokatëve, studentëve të drejtësisë ose juristëve.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Numri i ofruesve të ndihmës juridike ²⁵ në çështje civile dhe penale për 100 000 banorë, sipas seksit	Të dhëna administrative/të dhëna nga terreni	Përshtatur nga Qeveria e Mongolisë - "Arritja - e Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Raporti i Pestë i Progresit Kombëtar".
Ekzistenca e dispozitave ligjore ose traditës që kërkon që avokatët të ofrojnë shërbime pro bono për popullin indigjen	Intervistim eksperti/studim literature	Ky tregues mbulon një metodë alternative të ofrimit të shërbimeve ligjore për të varfrit. Zhvillimi i shërbimeve pro bono mund të jetë instrument i çmuar për rritjen e kapacitetit të sistemit ligjor për të zgjeruar qasjen në drejtësi për të varfrit në situatë të pafavorshme.
Ofrimi i ndihmës ligjore falas për të pandehurit indigjenë	Intervistim eksperti/studim literature	UNROLI (fokusi mbi drejtësinë penale)
Përqindja e shpenzimeve ligjore të mbuluara nga shteti në çështje ku ofrohet ndihmë juridike falas	Të dhëna administrative	Me qëllim që shërbimi i ndihmës juridike të jetë i efektshëm dhe me cilësi, ai duhet të ketë burimet e duhura. Ky tregues synon të sigurojë që shërbimet e ndihmës juridike të kenë buxhetin e duhur.
Nëse ndihma juridike përfshin programe të përjashtimit nga tarifa	Intervistim eksperti/studim literature Anketim i stafit administrativ dhe profesional të subjekteve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike Anketa e përdoruesit	CEPEJ ²⁶
Bërja e vlerësimit të të ardhurave dhe asetëve për dhënien e ndihmës juridike aplikantit bazuar në të ardhurat e vërteta ose asetet në dispozicion të personit që kërkon ndihmë	Intervistim eksperti/të dhëna administrative intervistim i nëpunësit të gjykatës	CEPEJ Rekomandim i përgjithshëm i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi
Cilësia e shërbimit juridik falas të ofruar	Anketë eksperti	WJP dhe UNROLI përfshijnë tregues të ngjashëm
Numri i ofruesve të ndihmës juridike që janë gra	Të dhëna administrative/të dhëna nga terreni	MESECVI
Përqindja e të pandehurve që kanë pasur avokat gjatë gjyqimit, sipas seksit	Të dhëna administrative	Përshtatur nga treguesit WJP

iii. Mundësia gjeografike

Gjykatat në largësi janë një tjetër pengesë e madhe për qasjen në drejtësi dhe përsëri kjo ndikon në mënyrë të zhdrejtë te të varfrit dhe të pafavorizuarit, përfshirë gratë dhe banorët e zonave rurale që kanë mundësi të pakta për mjete transporti. Distanca ndikon në aftësinë e njerëzve për qasje në drejtësi në shumë mënyra - udhëtimi në distanca të mëdha kërkon kohë dhe kushton. Mund të shkaktojë humbje të të ardhurave për shkak të orëve ose ditëve që një personi i duhet për të lënë punën për të udhëtuar në gjykatë dhe për të marrë pjesë në procese gjyqësor. Gratë e varfra janë veçanërisht në situatë të pafavorshme, sepse

ato mund të kenë të drejtë të kufizuar në burimet e familjes dhe të gëzojnë lëvizshmëri të kufizuar për shkak të traditës ose thjesht të mungesës së kohës, detyrimeve të kujdesit për fëmijët dhe mungesës së mjeteve të transportit. Masat e lehtësimit të aksesit në drejtësi të distancës së gjykatave duhet të bazohen në të dhëna administrative/objektive dhe të dhëna perceptimi me qëllim që të matin jo vetëm distancën fizike aktuale, por edhe masën se sa kjo e fundit ndikon në perceptimin e njerëzve për aksesueshmërinë e sistemit të drejtësisë.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Numri i gjykatave për 100 000 banorë dhe vendndodhja gjeografike	Të dhëna administrative	Përshtatur nga CEPEJ
% e njerëzve që jetojnë brenda (x kohe) nga vendi i gjykimit, sipas seksit	Të dhëna administrative/të dhëna nga terreni	Përshtatur nga treguesi i propozuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur dhe Namati në kuadër të dialogut për agjendën post-2015 për zhvillim.
% e njerëzve që raportojnë se aksesit fizik në gjykata është i mundur sa i përket distancës, sipas seksit	Anketa e njësisë ekonomike familjare	Ky tregues trajton çështjen e afërsisë gjeografike nga këndvështrimi i personi që kërkon drejtësi dhe synon të plotësojë të dhënat objektive mbi distancën e gjykatave. Të dhëna subjektive për afërsinë gjeografike janë thelbësore për të kapur rrethana specifike për disa zona ose njerëz, siç janë vështirësia e udhëtimit në disa rrugë, mungesa e mjeteve të transportit dhe pengesa socio-kulturore që kufizojnë lëvizshmërinë. Për shembull, në Indonezi, vetëm disa të anketuar të sondazhit të kryer nga PNUD dhe Qeveria e Indonezisë raportuan që "gjykatat ndodheshin brenda një distance të arritshme nga vendbanimi i tyre" (UN Women 2011: 54).
Ekzistenca e procedurave dhe ambienteve që ofrojnë privatësi (p.sh. salla të ndara) për denoncimin e krimet, marrjen e deklaramit, zonat e pritjes (listoni të gjitha procedurat dhe ambientet ekzistuese)	Anketë eksperti/ të dhëna terreni	Ekzistenca e procedurave dhe ambienteve që sigurojnë privatësi dhe konfidencialitet është element thelbësor i qasjes në sistemin e drejtësisë. Për shembull, në raste përdhunimi, ofrimi i sallave të ndara për viktimat dhe dëshmitarët kur japin deklaramin e tyre mund të minimizojë traumën dhe frikën dhe të krijojnë shtysë për denoncim. ²⁷
Ofrimi i qendrave lehtësisht të arritshme për referimin e rasteve të përdhunimit ose dhunës seksuale të viktimave duke ofruar ekzaminim shëndetësor dhe mjekoligjor, mbështetje për traumën dhe këshillim për viktimat	Anketë eksperti/ të dhëna terreni	Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), neni 25

Të dhënat për kohën e udhëtimit dhe perceptimin e distancës mund të plotësohen me të dhëna të disagreguara për ofrimin e transportit publik (nëse ka dhe kostoja) dhe mundësisë për transport privat dhe ekzistencën e pengesave informale, siç janë nevoja për të marrë leje nga udhëheqësit e komunitetit.

iv. Kosto

Kostot zyrtare dhe jo zyrtare gjithashtu përfaqësojnë një pengesë për qasje në drejtësi, akoma më shumë për të varfrit dhe akstë disavantazuarit- përfshirë gratë - që kanë të drejtë të kufizuar në burime ekonomike. Kostot e

përfaqësimit ligjor, tarifat gjyqësore, kostot e udhëtimit dhe humbja e të ardhura për shkak të mungesës së punësimit mund të kombinohen me kërkesat për rryshfet - duke penalizuar më shumë grupet vulnerabël.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
<p>Kosto mesatare e proceseve gjyqësore (përfshirë ndihmën ligjore/përfaqësimin) për padi që lidhen me çështje (palët e interesuara të zgjedhin një ose më shumë nga sa më poshtë sipas nevojave dhe përparësive të tyre):</p> <ul style="list-style-type: none"> • divorci • ekzekutimi kontrate • shkarkimi nga puna • prone të paluajtshme • paaftësie paguese • pretendimi trashëgimie • kujdestarie të fëmijëve • vjedhjeje me dhunë • vrasjeje me dashje, • përdhunimi • dhune në familje • dhune seksuale (të ndryshme nga përdhunimi dhe dhuna në familje) • urdhri kufizimi në raste të dhunës në familje, përfshirë përdhunimin 	<p>të dhëna administrative/të dhëna nga terreni/anketa e njësisë ekonomike familjare/ anketë eksperti</p>	<p>Përshtatur nga UNROLI Anketa e Zgjeruar për Kushtet e Jetesës në Timor - Leste (2008)</p>
<p>% e njerëzve që raportojnë se qasja në gjykatë është i përballueshëm, sipas seksit</p>	<p>Anketa e njësisë ekonomike familjare</p>	<p>Përshtatur nga WJP</p>
<p>% e njerëzve që raportojnë se u është kërkuar të paguajnë rryshfet, pagesa informale ose në forma të tjera, përfshirë favore seksuale, për të filluar ose përshpejtuar një proces gjyqësor ose për të marrë një vendin favorizues, sipas seksit</p>	<p>Anketë eksperti/ Intervista/të Anketa e njësisë ekonomike familjare</p>	<p>Propozuar nga UNODC në kuadër të dialogut për agjendën post-2015 për zhvillim, të përfshirë në "Treguesit me përparësi për objektivin 16" të propozuar nga Ekipi i Mbështetjes Teknike për agjendën post-2015 për zhvillim</p>

v. Koha

Vonesat e panevojshme në proceset gjyqësore dëmtojnë qasjen në drejtësi duke i privuar paditësit nga një zgjidhje në kohë për ankesën e tyre, viktimat e krimeve të mbrojtjes (për shembull, nëpërmjet një urdhri ndalues ose mbrojtjes) dhe të dyshuarit e ndaluar nga një proces i përsheptuar që i gjen ata përgjegjës. Përveç kësaj, vajtje-ardhjet e

përsëritura dhe të gjata në gjykatë mund të përbëjnë një barrë të tepërt. Ashtu si distanca dhe kostoja, kohëzgjatja e procesit ka të ngjarë të prekë individë dhe grupe të ndryshme në mënyra të ndryshme, duke garantuar mbledhjen e të dhënave të ndara administrative, të dhëna të opinionit dhe të perceptimit.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
<p>Kohëzgjatja mesatare e proceseve në çështje (palët e interesuara të zgjedhin një ose më shumë nga sa më poshtë sipas nevojave dhe përparësive të tyre):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) divorci 2) ekzekutimi kontrate 3) shkarkimin nga puna 4) prone të paluajtshme 5) paaftësie paguese 6) pretendimi trashëgimie 7) kujdestarie të fëmijëve 8) vjedhjeje me dhunë 9) vrasjeje me dashje, 10) përdhunimi 11) dhune në familje 12) dhune seksuale (të ndryshme nga përdhunimi dhe dhuna në familje) 13) urdhri kufizimi në raste të dhunës në familje, përfshirë përdhunimin <p>Koha që kërkon zgjidhja e çështjes, e ndarë sipas seksit të paditësit/të të pandehurit/të viktimës/të autorit dhe llojit të çështjes.</p>	Të dhëna administrative	CEPEJ
Sa kohë kërkoi zgjidhja e një çështjeje- e ndarë sipas seksit të të anketuarve?	Anketa e përdoruesit	Përshtatur nga WJP
Sa problem i rëndë është kohëzgjatja e çështjes në gjykata penale, civile dhe tregtare/forume gjykimi tradicional/fetar?	Anketë eksperti/ Intervista/anketa e përdoruesit	Përshtatur nga WJP (treguesi i WJP trajton vetëm mekanizmat shtetërorë të zgjidhjes së drejtësisë)
Ekzistenca e masave të ndërmjetme (listoni të gjitha masat ekzistuese, siç janë mbikëqyrja ose urdhra kufizimi)	Intervistim eksperti/ studim literature	Ekzistenca e masave të ndërmjetme që ndikojnë ndjeshëm në afatet kohore të reagimit të sistemit të drejtësisë ndaj nevojave të njerëzve. Parashikimi i masave të ndërmjetme si mbikëqyrja ose urdhrat e kufizimit, është veçanërisht i rëndësishëm për shembull në çështjet e dhunës në familje.
Numri i të dyshuarve të ndaluar në paraburgim për më shumë se 12 muaj, i ndarë sipas seksit	Të dhëna administrative	Përfshirë në "Treguesit me përparësi për objektivin 16" të propozuar nga Ekipi i Mbështetjes Teknike për agjendën post-2015 për zhvillim

vi. Gjykata të specializuara

Ekzistenca e gjykata të specializuara me procese të thjeshtuara dhe më pak të kushtueshme, siç janë gjykatat për çështje familjare, ose gjykatat për padi të vogla mund të ulë ndjeshëm pengesat ndaj aksesit. Disa grupe, siç janë pronarët e bizneseve të vogla (një kategoritë që

përfshin shumicën e grave pronare të bizneseve) ose bashkëshortëve që kërkojnë divorc ose pagesë të detyrimit ushqimor, mund të përfitojnë veçanërisht nga ofrimi i proceseve gjyqësore më të lira, më të thjeshta dhe më të shpejta.

Treguesit	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Ekzistenca e një gjykatë për padi të vogla ose një procedurë e shpejtë për padi të vogla dhe shuma maksimale për një padi të vogël (si përqindje e të ardhurave për frymë)	Anketë eksperti/ intervistë	WBL
Ekzistenca e një gjykate të specializuar ose procedure për çështjet e dhunës në familje	Anketë eksperti	WBL
Numri i gjykatave për padi të vogla/çështje familjare për 100 000 banorë dhe vendndodhja gjeografike	Të dhëna administrative	Përshtatur nga CEPEJ
% e njerëzve që jetojnë brenda (x kohe) nga vendi i (gjykata e posaçme)	Të dhëna administrative/të dhëna nga terreni	Përshtatur nga treguesi i propozuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur dhe Namati në kuadër të dialogut për agjendën post-2015 për zhvillim.
% e njerëzve që raportojnë se hyrja fizike në (gjykata të posaçme) është e mundur sa i përket distancës, sipas seksit	Anketa e njësish ekonomike familjare	Tregues i ri nga Paneli i Nivelit të Lartë të Personave të Shquar për Agjendën post-2015 për Zhvillimin.
Numri i çështjeve të marra dhe të shqyrtuara nga gjykatat e posaçme në një vit kalendari, përfshirë: çështjet në pritje më 1 janar çështje të ardhura çështje të zgjidhura çështje të rrëzuara/çështjet në pritje që dalin nga sistemi (pushim) më 31 dhjetor	Të dhëna administrative	Përshtatur nga treguesit e CEPEJ-it

vii. Drejtësia e procesit (përfshirë të drejtat e viktimave) dhe rezultati

Aftësia e sistemit të drejtësisë për të siguruar një proces dhe rezultat të drejtë dhe jodiskriminues është element thelbësor i qasjes në drejtësi. Qasje në drejtësi do të thotë më shumë se të jesh në gjendje të sjellësh një kërkesë para gjykatës: përfshin gjithashtu të drejtën për një proces që gjykon mosmarrëveshjet në mënyrë të drejtë dhe pa

anshmëri dhe diskriminim; që çon në një rezultat që të dyja palët e konsiderojnë një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes së tyre; që zbatohet/ekzekutohet; dhe që ofron mbrojtje dhe mbështetje të duhur për viktimat e krimeve, duke përfshirë shmangien e viktimizimit dytësor.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Drejtësia civile dhe penale është e lirë nga diskriminimi gjinor	Anketë eksperti	WJP
Ekzistenca e shërbimeve dhe procedurave mbështetëse të viktimave (listoni të gjitha shërbimet dhe proceset ekzistuese siç janë e drejta e viktimave të krimit për t'u shoqëruar nga persona mbështetës) gjatë gjyqimit	Intervistim eksperti/ studim literature	Përveç gjyqimit të drejtë, shërbimet mbështetëse janë thelbësore për të garantuar qasjen e efektshme në drejtësi për viktimat e krimeve. Strehat, mbështetja dhe këshillimi për traumën, këshillat për çështje financiare në lidhje me krimin, këshillat për riskun dhe parandalimin e viktimizimit dytësor, janë të gjitha masa të parashikuara në Direktivën 2012/29/BE, 25 tetor 2012 (Direktiva për Viktimat) për mbrojtjen e të drejtave themelore të viktimave, përfshirë qasjen në drejtësi (FRA 2014).
Rezultatet e çështjeve, të ndara sipas llojit të mosmarrëveshjes dhe seksit të viktimës/autorit, kërkuarit/të pandehurit	Vlerësim i dosjeve gjyqësore	Rekomandim i përgjithshëm i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi

3.2.3. Pala kërkuese

i. Problemet më të zakonshme të drejtësisë të përjetuara nga qytetarët dhe masat e marra për qasjen në drejtësi

Të mësuarit për nevojat dhe sfidat e qytetarëve në qasjen në drejtësi është thelbësor për të siguruar që politikat dhe ndërhyrjet të fokusohen në mënyrë efektive në çështjet përkatëse. Megjithatë, treguesit që fokusohen në këtë fushë janë të paktë. Të dhënat mbi llojin e mosmarrëveshjeve që përjetojnë gratë dhe burrat dhe krimet e kryera,

veprimet e ndërmarra nga qytetarët dhe pengesat ndaj aksesit – të hasura apo të perceptuara – duhet të mblidhen përmes një sërë burimesh, përfshirë anketat e familjeve dhe përdoruesve, intervistat e ekspertëve, të dhënat administrative dhe vlerësimi i dosjeve, me qëllim plotësimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Llojet dhe numri i ankesave të depozituara pranë mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të ndara sipas seksit	Te dhëna administrative/ vlerësim i dosjes së çështjes	Rekomandim i përgjithshëm i Komitetit CEDAW për qasjen e grave në drejtësi
Cështjet kryesore të gjyqeshme të përjetuara nga qytetarët, të ndara sipas seksit	Anketa e përdoruesit/ intervistim eksperti	Anketa të standardit të jetesës Afrobarometer
Masat e marra për të zgjidhur një mosmarrëveshje (përfshirë përdorimin e një mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve) dhe arsyeja, të ndara sipas seksit	Anketa e përdoruesit/ intervistim eksperti/ vlerësim i dosjes së çështjes	Anketa të standardit të jetesës
Shkalla e dhunës së pa denoncuar: numri i vajzave dhe adoleshentëve, grave dhe të moshuarëve që kanë qenë viktimë të formave të ndryshme të dhunës gjatë 12 muajve të fundit dhe që nuk i kanë denoncuar këto akte të dhunës, i pjesëtuar me numrin total të grave në grupmoshën e tyre (të dhëna të ndara sipas moshës, përfshirë vajzat mbi moshën e dhenies së pelqimit dhe nën moshën e dhenies së pelqimit)	Anketa e njesisë ekonomike familjare	MESECVI Komiteti i Ekspertëve (CEVI)
Pengesat kryesore ndaj qasjes në drejtësi, të ndara sipas seksit	Anketa e njesisë ekonomike familjare (pyetje për të anketuarit që kanë përjetuar një mosmarrëveshje, nëse kanë ndermarre ndonjë veprim apo jo /anketa e përdoruesit/ intervistim eksperti	Ky tregues synon të krijojë njohuri të drejtperdrejte për pengesat (të perceptuara ose reale) që grata dhe burrat hasin kur përpiqen të aksesojnë drejtësinë. Këto pengesa variojnë nga mungesa e burimeve ekonomike, të mungesa e besimit në sistemin e mungesa e ndërgjegjesimit për të drejtat dhe zgjidhjet ligjore në dispozicion. Aftësia për të dalluar një ose më shumë probleme është thelbësore për formulimin e politikave dhe ndërhyrjeve të suksesshme që synojnë rritjen e qasjes në drejtësi (Komiteti CEDAW 2015: 4, 11-13).

ii. Ndërgjegjësimi ligjor

Mungesa e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe mekanizmat në dispozicion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe paaftësia për të shfrytëzuar sistemin e drejtësisë kufizojnë ndjeshëm qasjen në drejtësi të shumë njerëzve – veçanërisht ata mes grupeve të pa favorizuara, përfshirë gratë, aftësia e të cilave për të kuptuar dispozitat ligjore dhe për

t'u orientuar me proceset gjyqësore mund të dëmtohet nga edukimi i përgjithshëm i ulët dhe ligjor (ose mungesa e tij), mungesa e kohës dhe burimet e pakta ekonomike. Ndonëse sfiduese, matja e ndërgjegjësimit ligjor është çelësi për të vlerësuar kapacitetin e palës kërkuese për t'ju qasur drejtësisë.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Masa ne te cilen burrat dhe grate kane dijeni per ligje/te drejta specifike te rendesishme ne kontekstin kombetar	Anketa e njesise ekonomike familjare	Pershtatur nga treguesi i propozuar nga Dialogu Nderkombetar per Forcimin e Paqes dhe Shtetit
Masa ne te cilen grate dhe burrat kane dijeni per pese mekanizmat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve qe jane ne dispozicion	Anketa e njesise ekonomike familjare	Pershtatur nga Anketa per Standardet e Jeteses ne Gane (Raundi 6)
Masa ne te cilen grate dhe burrat besojne se bashkeshorti justifikohet nese godet ose rreth gruan e tij ne situatat e meposhtme: a) nese ajo del pa i thene b) nese ajo le pas dore femijet c) nese ajo debaton me ate d) nese ajo refuzon te beje seks me ate e) nese ajo djeg ushqimin	Anketa e njesise ekonomike familjare/ moduli per burrat dhe moduli per grate	DHS
Numri i grave dhe burrave qe kane perfituar nga ndihma juridike, sipas seksit dhe te ardhurave	Te dhena administrative	Ky tregues synon te mase qasjen aktual te grave ne ndihmen juridike. Edhe kur ekzistojne sisteme te ndihmes juridike dhe ato jane te krijuara si duhet, grate mund te hasin pengesa ne qasje, sic jane vlerat kulturore dhe sociale qe nuk i inkurajojne te kerkojne ndihme. Te dhena per perdorimin aktual te ndihmes juridike nga grate hedhin drite ne pengesat e pales kerkuese ndaj qasjes qe perndryshe do te ishin anashkaluar.
Ekzistenca dhe ndikimi i programeve te edukimit ligjor dhe ndergjegjesimit ligjor per grate dhe burrat, duke u fokusuar ne barazine gjinore, mosdiskriminimin, dhunen me baze gjinore dhe fusha te tjera me interes te vecante per grate. Numri dhe permbajtja e programeve ne vitin e fundit kalendarik Numri i grave dhe burrave qe kane marre pjese ne programe Ndikimi i matshem i programeve ne drejtim te edukimit dhe ndergjegjesimit ligjor te permiresuar	Te dhena terreni dhe administrative/ anketa e pjesemarresit (baza e references dhe vleresimi)	Ky tregues synon te mase dhe te pershpjetoje perpjekjet (nga shteti dhe nga shoqeria civile) per te permiresuar aftesine e grave per te mbrojtur te drejtat e tyre dhe per te perdorur sistemet ligjore dhe gjyqesore dhe ndikimin e ketyre perpjekjeve. Keto programe synojne te jene ne favor te zhdrejte per grate nisur nga edukimi dhe ndergjegjesimi i tyre me i ulet ligjor krahasuar me burrat dhe jane thelbeshore per te bere te efektshem per te gjithë qasjen ne drejtesi.

Të dhënat për edukimin, ndërgjegjësimin për të drejtat dhe lëvizshmërinë (përfshirë mundësinë për mjete transporti) të ndara sipas seksit mund të ndihmojnë për të kuptuar më mirë nevojat e grave dhe burrave, duke mundësuar sinkronizimin e ndërhyrjeve me fokus në ndihmën ligjore/shërbime të ndihmës juridike.

iii. Pushimi

Edhe kur një mosmarrëveshje ose një shkelje hyn në sistemin e drejtësisë,²⁸ nuk është e sigurt që procesi gjyqësor do të arrijë në fazat përfundimtare dhe do të merret një vendim përfundimtar për çështjen. Rruga në zinxhirin e drejtësisë është një përpjekje komplekse që kërkon burime, aftësi dhe vullnet si nga qytetarët ashtu edhe nga profesionistët e drejtësisë. Kërkuarit dhe viktimat (kur ligji e lejon) mund të heqin dorë nga çështja, për shkak të mungesës së njohurive ligjore dhe aftësisë për të ndjekur zhvillimet në sistem, ose mungesës së burimeve ekonomike, kohës ose interesit. Ata gjithashtu mund ta bëjnë këtë për shkak të presioneve sociale ose familjare,

ose frikës nga hakmarrja. Çështjet mund të rrëzohen nga policia, prokurorët ose gjyqtarët për shkak të pamundësisë për të gjetur autorin, mungesës së provave ose çështjeve të tjera procedurale.²⁹ Ky fenomen, i njohur si pushim, është veçanërisht i mprehtë në rastet e përdhunimeve, ku shkalla e çështjeve të rrëzuara është e lartë dhe vetëm një përqindje e vogël e çështjeve përfundojnë me dënimin e autorëve.³⁰ Mbledhja e të dhënave për shkallën e pushimit është thelbësore për të identifikuar më mirë barrierat dhe "gropat" që kufizojnë aftësinë e njerëzve për të marrë rezultate të drejta drejtësie - dhe për të hartuar strategji për të trajtuar problemin.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Norma vjetore e pushimit në çështje përdhunimi, sipas fazës procedurale dhe arsyes së pushimit, e ndarë sipas faktit nëse viktimat është apo jo nën moshë	Të dhëna administrative/intervistim eksperti	Pushimi i çështjes është veçanërisht kritik në çështje të përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale, përfshirë dhunën në familje. Megjithatë, të dhënat për pushimet janë të pakta. Këta tregues synojnë të matin fenomenin e pushimit dhe të përshpejtojnë mbledhjen e të dhënave përkatëse.
Norma vjetore e pushimit të çështjeve të dhunës në familjeve, sipas fazës procedurale dhe arsyes së pushimit, e ndarë sipas faktit nëse viktimat është apo jo nën moshë	Të dhëna administrative/intervistim eksperti	Gjithashtu, presioni social për të rrëzuar një çështje zakonisht është më i lartë për gratë dhe vajzat mbi moshën e ligjshme sesa për fëmijët (të miturit). Prandaj, matja e normës së pushimit për këto dy grupe veçmas do të hedhë dritë në dimensionin aktual të problemit.
Norma vjetore e pushimit të çështjeve të dhunës seksuale, sipas fazës procedurale dhe arsyes së pushimit, e ndarë sipas faktit nëse viktimat është apo jo nën moshë	Të dhëna administrative/intervistim eksperti	

iv. Besimi në sistemin (sistemet) e drejtësisë

Perceptimi publik për drejtësinë e proceseve gjyqësore dhe rezultatet përcakton gjithashtu shkallën e qasjes në një sistemi drejtësie. Mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë pengon qasjen në drejtësi nga qytetarët që nuk kanë besim se ankesat e tyre do të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe efektive. Distanca kulturore, vlerat kontradiktore, perceptimet e korrupsionit, mungesa e efikasitetit

dhe diskriminimi janë të gjithë elementë që mund të kontribuojnë për t'i bërë qytetarët të kujdesshëm ndaj makinerisë së drejtësisë. Matja e nivelit të besimit në sistemin e drejtësisë hedh dritë mbi mënyrën se si shërbimet e drejtësisë u përgjigjen nevojave të njerëzve.³¹ Të dhënat e ndara mbi perceptimin japin informacion të vlefshëm se si gratë dhe burrat i përjetojnë proceset e drejtësisë.

Treguesi	Burimet e të dhënave/mjetet e verifikimit	Përdorur/propozuar nga/komente
Nëse qytetarët shprehin besimin që ata mund të marrin ndihmën dhe përfaqësimin ligjor cilësor dhe të përballueshëm sipas seksit	Anketa e njësisë ekonomike familjare	Përshtatur nga treguesi i propozuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur dhe Namati në kuadër të dialogut për agjendën post-2015 për zhvillim.
% e njerëzve që shprehin besimin që do të trajtoheshin me drejtësi dhe pa diskriminim nga policia / gjyqtarët / prokurorët / udhëheqësit tradicionalë/udhëheqësit fetarë, sipas seksit	Anketa e njësisë ekonomike familjare	UNROLI Afrobarometër
% e njerëzve që kanë përjetuar të drejtën për denoncimin e mosmarrëveshjes pranë një mekanizmi të kënaqshëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas seksit ³²	Anketa e njësisë ekonomike familjare	Përfshirë në "Treguesit me përparësi për objektivin 16" të propozuar nga Ekipi i Mbështetjes Teknike për agjendën post-2015 për zhvillim

ANEKS: QASJET PREMTUESE PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES NË DREJTËSI³³

Barrierat që kufizojnë aftësinë e grave për qasje në drejtësi janë të shumta dhe të një natyre të ndryshme. Ato përfshijnë format, funksionet dhe kulturën institucionale; barrierat ekonomike dhe gjeografike; dhe vlerat dhe qëndrimet socio-kulturore që i pengojnë gratë të angazhohen me mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve publike dhe organet e zbatimit të ligjit. Për shkak se janë komplekse dhe shumëdimensionale, trajtimi i barrierave ndaj qasjes së grave në drejtësi ka rezultuar sfidues. Megjithatë, ekzistojnë qasje premtuese që kanë rezultuar të suksesshme për lehtësimin e qasjes së grave në sistemin e drejtësisë.

Këto përfshijnë ndërhyrje që synojnë disa nga elementët e zinxhirit të drejtësisë që ndikojnë më shumë në aftësinë e grave për qasje në drejtësi – të tilla si lëvizshmëria e kufizuar, e drejta e kufizuar në burimet ekonomike, mungesa e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor, paragjykimet gjinore dhe mungesa e ndjeshmërisë gjinore mes profesionistëve të drejtësisë dhe vështirësia e orientimit në kompleksitetin e zinxhirit të drejtësisë, që shpesh rezultojnë në norma të larta të pushimit.

Ndihma juridike dhe ndihma ligjore e mundshme

Këshillat dhe përfaqësimi ligjor i disponueshëm dhe i përballueshëm janë thelbësorë për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë. Edhe kur ekzistojnë ligje dhe sisteme të barabarta, individët mund të mos jenë në gjendje të ushtrojnë dhe të mbrojnë të drejtat e tyre në praktikë, pasi u mungojnë njohuritë ose burimet për të hyrë dhe për t'u orientuar në sistemin e drejtësisë. Gratë janë në situatë më pak të favorshme se burrat, duke pasur parasysh se shkalla e tyre e edukimit, njohjes me informacionin, ndërgjegjësimin ligjor dhe e drejta për burimet ekonomike janë mesatarisht më të ulëta dhe se barrierat socio-kulturore shpesh frenojnë aftësinë e tyre për t'u drejtuar drejtësisë që të mbrojnë të drejtat e tyre. Ky "boshllëk i kapaciteteve" nga pala kërkuese e drejtësisë mund të trajtohet duke ofruar ndihmë juridike

cilësore, të përballueshme dhe me ndjeshmëri gjinore dhe forma të tjera të ndihmës juridike, përfshirë programet e ndihmës juridike formale (të shtetit), klinikat e ndihmës juridike të ngritura nga organizata të shoqërisë civile civilët dhe programet e këshillimit ligjor dhe ndihmës ligjore që mbështeten në punën e juristëve. Programet e ndihmës juridike dhe ndihmës ligjore të fokusuar në qasjen e grave në drejtësi janë zbatuar në një sërë vendesh dhe kanë dhënë rezultate pozitive. Në Guatemalë, Defensoría de la Mujer Indígena (DEMI, Zyra e Ndihmës Juridike për Gratë Indigjene) u krijua nga qeveria pas marrëveshjes së paqes të vitit 1996. DEMI ka personel gra indigjene avokate dhe punonjëse sociale, dhe fokusohet në rastet e dhunës dhe diskriminimit ndaj grave indigjene. Të dhënat e vitit 2007 tregojnë se DEMI mori 2 600 raste atë vit, nga të cilat 85% ishin raste të dhunës në familje, 11% ishin raste përdhunimi dhe 4% ishin raste të diskriminimit etnik (DEMI 2007; Sieder dhe Sierra 2010). Po kështu, Komiteti i Avancimit Rural të Bangladeshit ofron edukim ligjor dhe këshilla ligjore për gratë, dhe ka ndihmuar gratë të paraqesin dhe të ndjekin pretendimet e trashëgimisë dhe të denoncojnë martesën e paligjshme, poligaminë dhe rastet e pajës (UN Women 2012: 57). Pemberdaayan Perempuan Kepala Keluarga i Indonezisë (PEKKA, Fuqizimi i Grave Kryefamiljare) ofron fuqizim ligjor për gratë kryefamiljare. Në vitin 2007, nëpërmjet punës të avokatisë që përfshinte forume me shumë palë

të interesuara që bashkonin gjyqtarët, policinë, qeverisjen vendore dhe OJQ-të, PEKKA lehtësoi ndryshimin e politikave që çuan në një rritje të shpërndarjes së buxhetit për gjykatat fetare e cila lejoi krijimin e një programi të ndihmës juridike që ofronte përjashtim pagese për të varfërit. Midis 2007 dhe 2010, numri i të varfërve që përdorin gjykatat fetare u rrit më shumë se 10 herë, ndërsa numri i grave që përdorin në gjykatat e qarkut (fetare) është katërfishuar (Sumner, Zurstrassen dhe Lister 2011).

Programet që përfshijnë juristët kanë qenë prej kohësh një tipar i programeve të fuqizimit ligjor dhe ndihmës ligjore. Zakonisht juristët janë anëtarë të komunitetit të trajnuar për bazat e së drejtës, duke marrë parasysh kontekstin lokal socio-kulturor dhe që janë të aftë të komunikojnë me njerëzit që kërkojnë këshilla ligjore dhe t'i mbështetin ata sipas kushteve të tyre. Në veçanti, të dhënat tregojnë se gratë juristet janë të efektshme në përgjigjen ndaj nevojave të grave, duke përfshirë rastet e dhunës seksuale, dhunës në familje dhe përdhunimit – çështje për të cilat gratë mund të jenë të kujdesshme ose në pamundësi për shkak të barrierave socio-kulturore – që të diskutojnë me burrat.³⁴

Shërbime me një ndalesë

Kur një çështje çohet në gjykatë kërkon një sërë hapash, përfshirë mbledhjen e një sërë dokumentesh, të tilla si vërtetimi i identitetit dhe prova në mbështetje të çështjes. Kjo nga ana tjetër përfshin edhe vajtjen në zyra të ndryshme, shpesh të vendosura në pjesë të ndryshme të qytetit, nëse jo në qytete të ndryshme. Jo të gjithë njerëzit që kërkojnë të sjellin një çështje në gjykatë ose të denoncojnë një krim e kanë aftësinë të gjejnë rrugën e tyre në atë që shpesh është një labirint zyrash dhe procedurash – sepse kjo u merr shumë kohë, nuk kanë mundësi për mjetet e transportit, ose thjesht nuk dinë ku të shkojnë. Si pasojë, rastet rrëzohen (pushimi i çështjes) ose nuk depozitohen kurrë tek organet kompetente dhe humbasin mes të çarave të sistemit. Duke pasur parasysh barrierat më të larta institucionale dhe sociale me të cilat përballen gratë, ato janë veçanërisht të ndjeshme ndaj pushimit të çështjeve. Pushimi dhe mos raportimi janë veçanërisht të larta në rastet e përdhunimeve dhe dhunës seksuale, për shkak të natyrës shumë të ndjeshme të çështjeve, rëndësisë së mbledhjes në kohë të provave dhe të presionit që viktimat shpesh përjetojnë për të rrëzuar ose për mos çuar një çështje në gjykatë (UN Women 2011: 50). Një qasje premtuese për të adresuar çështjen është krijimi i shërbimeve të integruara, ose shërbimeve “me një ndalesë”

- objekte që ofrojnë një sërë shërbimesh dhe ulin numrin e hapave në proces duke lehtësuar koordinimin midis zyrave të ndryshme. Shërbimet me një ndalesë kanë rezultuar veçanërisht të efektshme në ndihmën që u jepet grave viktimave të dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Zakonisht ato ndodhen në spitale ose qendra shëndetësore, janë shpesh pika e parë e kontaktit me institucionet e shtetit për viktimat e dhunës seksuale dhe janë të pajisura me personel mjekësor, punonjëse sociale dhe punonjëse policie, të cilat kanë marrë trajnime të veçanta për të punuar si një organ i vetëm i integruar. Qendrat e Kujdesit Thuthuzela në Afrikën e Jugut janë një shembull i shërbimeve me një ndalesë për viktimat e dhunës seksuale. Të prezantuara si pjesë e strategjisë kombëtare kundër përdhunimit, ato janë të vendosura në spitale shtetërore dhe u ofrojnë viktimave të përdhunimit kujdes fizik dhe psikologjik, duke i udhëhequr ato në procesin e denoncimit të krimit, ndërsa monitoruesit e rasteve sigurohen që dokumentacioni i viktimave të mbahet në rregull dhe që shërbimet të jenë të koordinuara për të shmangur viktimizimin dytësor. Të dhënat tregojnë se qendrat kanë qenë të efektshme për shkurtime të kohës së përfundimit të gjykimit: për rastet e trajtuara nga qendrat kjo është mesatarisht shtatë muaj e gjysmë, krahasuar me mesataren kombëtare prej dy vjetësh. Modeli i Qendrave të Kujdesit Thuthuzela është përdorur nga vende të tjera si Etiopia dhe Kili (UN Women 2011: 47). Po kështu, mbështetja e integruar për viktimat e dhunës në familje ofrohet në qendrat me një ndalesë për krizat në Malajzi në spitalet shtetërore (Banka Botërore 2011: 312).

Njësi policore vetëm me gra, ofruese drejtësie gra dhe trajnim gjinor për profesionistët e drejtësisë

Paragjykimet gjinore mes policisë dhe profesionistëve të drejtësisë përbëjnë një pengesë të madhe për qasjen e grave në drejtësi, duke i privuar ato nga trajtimi, proceset dhe rezultatet e drejta. Nga ana e tyre, gratë shpesh nuk ndihen rehat që t'ju tregojnë burrave për krimet e kryera ndaj tyre, ose normat socio-kulturore i pengojnë ta bëjnë këtë gjë. I tillë është veçanërisht rasti me episodet e dhunës seksuale, por mund të vlejë edhe për diskutimin e divorcit ose çështjeve familjare me burrat. Gjatë fokus grupeve të kryera në vitin 2013 si pjesë e kërkimit të kryer mbi qasjen e grave në drejtësi në Afganistan (Marchiori 2014), gratë treguan episode të

abuzimit të kryera nga policia ndaj grave viktime të përdhunimit ose formave të tjera të dhunës seksuale dhe dhunë në familje, dhe shprehën besimin e tyre të ulët dhe madje edhe frikën nga institucioni. Një qasje që e ka trajtuar me sukses këtë çështje ka qenë ngritja e njësisë policore vetëm për gratë – duke ulur kështu barrierat për akses në pikën e saj të hyrjes. E përdorur në Brazil që nga viti 1985, kjo qasje është aplikuar me rezultate pozitive në Peru, Guatemalë dhe Argjentinë (Banka Botërore 2011:313). Kohët e fundit, 188 njësi policore vetëm për gratë u ngritën në zonat urbane dhe rurale në Tamil Nadu, Indi. Njësitë, të cilat fokusohen në krimet kundër grave, kanë rritur mundësinë e grave dhe denoncimin e rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës në familje (Jubb dhe Izumino 2003). Gjithashtu, rritja e pjesëmarrjes së grave në gjyqësor ka një ndikim pozitiv potencial në qasjen e grave në drejtësi. Edhe pse nuk ka prova të qëndrueshme që tregojnë se gratë gjyqtare kanë më shumë gjasa të vendosin në favor të grave ose të jenë imune ndaj paragjytimeve gjinore, pjesëmarrja e grave në gjyqësor rezultoi në një institucion më të balancuar dhe të larmishëm, ku ligjërata për të drejtat dhe privilegjet mund të pasurohet me zëra të ndryshëm. Papua Guinea e Re zbatoi politika të reja për përfshirjen e grave mes magjistratëve të fshatit duke filluar nga viti 2000. Në vitin 2004, kishte 10 gra magjistrate fshati; deri në vitin 2011, numri u rrit në 700, ndërsa 300 gra punonin si nëpunëse gjyqësore dhe pajtimi, me efekte premtuese për qasjen e grave në drejtësi. Në veçanti, magjistratet gra ishin në gjendje të drejtonin vëmendjen e magjistratëve meshkuj te nevojat për të aplikuar një qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj problemeve të ngritura nga çështjet që vinin para tyre.³⁵ Në fund, ofrimi i trajnimeve të detyrueshme për barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe dhunën ndaj grave gjithashtu rrit mundësitë e grave për të marrë trajtim të drejtë dhe rezultate të drejtësisë. profesionistët e drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit që kanë marrë pjesë në këto trajnime raportojnë se kanë fituar një këndvështrim të ndryshëm në trajtimin e rasteve të ndjeshme që përfshijnë gratë (Banka Botërore 2011: 313).

Gjykata të lëvizshme

Në përpjekje për të sjellë drejtësinë më pranë grave, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, gjykatat e lëvizshme janë përdorur në një sërë vendesh, përfshirë Somaliland, Sierra Leone, Pakistan, Peru dhe Republikën Demokratike të Kongos. Me gjyqtarë të rregullt dhe personel të gjykatës, gjykatat e lëvizshme udhëtojnë në komunitetet ku mungon shërbimi në ditët e planifikuara dhe zhvillojnë aty seanca. Ato zakonisht trajtojnë mosmarrëveshjet e vogla për prona, çështjet e

detyrimit ushqimor dhe kujdestarisë dhe mosmarrëveshjet e tjera familjare – të cilat prirën të jenë çështjet ligjore që prekin më shumë gratë. Në Peshawar, Pakistan, gjykatat e lëvizshme të mbështetura nga PNUD nuk vendosin tarifa gjyqësore dhe ofrojnë mundësinë e zgjidhjes së çështjes përmes ndërmjetimit, në vend që të presin për një vendim zyrtar. Në Sierra Leone, Somaliland dhe Republikën Demokratike të Kongos, gjykatat e lëvizshme janë përdorur për të ndihmuar në rindërtimin e makinerisë së drejtësisë pas një periudhe konflikti gjatë së cilës institucionet ishin shembur, infrastruktura fizike ishte shkatërruar, burimet njerëzore ishin të pakta dhe sundimi i ligji ishte tronditur. Në veçanti, në Republikën Demokratike të Kongos, gjykatat e lëvizshme janë përdorur me sukses për të trajtuar dhunën e përhapur seksuale, të cilën gjykatat e rregullta tashmë të mbingarkuara dhe me staf të pamjaftueshëm nuk ishin në gjendje ta trajtonin (PNUD 2014).

Gjykata të specializuara dhe procedura të posaçme

Në përfundim, krijimi i gjykatave të specializuara të financuara në mënyrën e duhur dhe me staf të specializuar të trajnuar siç duhet për të adresuar çështjet me interes të veçantë për gratë është një tjetër mjet për të rritur qasjen e grave në drejtësi dhe për të përmirësuar përvojën e tyre me drejtësinë. Procedurat e thjeshtuara, tarifat më të ulëta ose përjashtimi nga tarifat, dhe dispozitat e veçanta për përsheptimin e procesit (procedurë e shpejtuar) i bëjnë këto gjykata më lehtësisht të aksesueshme dhe të përshtatura me nevojat e grave. Përfitimet e tjera të gjykatave të specializuara përfshijnë mundësinë e zhvillimit të kompetencave të larta mes profesionistëve gjyqësorë të cilët fokusohen në një fushë të caktuar, dhe dukshmërinë e këtyre gjykatave, pasi sipas të dhënave në disa raste funksionet e tyre njihen më mirë nga publiku se ato të gjykatave të rregullta. Gjykatat familjare janë ndoshta shembulli më i zakonshëm i gjykatave të specializuara dhe ekzistojnë (qoftë si gjykatë e veçantë ose si seksione të gjykatave të rregullta) në vende të ndryshme si Afganistani, Maroku³⁶ dhe Shtetet e Bashkuara. Kohët e fundit, një numër vendesh kanë ngritur gjykata, zyra ose procedura të veçanta për t'iu përgjigjur dhunës ndaj grave. Në Uells (Mbretëria e Bashkuar), procedurat e përsheptuara kanë përgjysmuar kohën mesatare të shqyrtimit të rasteve të dhunës në familje dhe në Afrikën e Jugut, gjykatat për shkelje seksuale kanë një normë më të lartë dënimi (70%) se gjykatat e zakonshme dhe vlerësohen nga stafi, familjet e viktimeve dhe vetë viktimat.³⁷

BIBLIOGRAFIA

- Berg, L.-A. and D. Desai. 'Background Paper: Overview on the Rule of Law and Sustainable Development for the Global Dialogue on Rule of Law and the Post-2015 Development Agenda.' UNDP, 2013. Available from <http://bit.ly/1rqf5fR>
Accessed 12 February 2016.
- Berenschot, W. and T. Rinaldi. 'Paralegalism and legal aid in Indonesia. Enlarging the shadow of the law.' Van Vollenhoven Institute for Law, Governance, and Development, Open Society Institute and UNDP, 2011.
- CEDAW Committee. General recommendation on women's access to justice, CEDAW/C/GC/33, 2015.
- Chiongson, R. A., et al. 'Role of law and justice in achieving gender equality', 2011. Background paper for the World Development Report 2012.
- Council of Europe. Administrative data collection on domestic violence in Council of Europe member states. EG-VEW-DC (Study), 2008.
- Feasibility study: Equal access of women to justice. Strasbourg: Council of Europe Publishing, 2013.
- Council of Europe's Gender Equality Strategy 2014-2017. Strasbourg: Council of Europe Publishing, 2014a.
- 'Tackling the gaps in research and the lack of data disaggregated by sex concerning women's equal access to justice'. Seminar of the Council of Europe Gender Equality Commission, 26 and 27 June 2014. Paris, 2014b. Available from www.coe.int/equality-Paris2014.
Accessed 12 February 2016.
- 'Ensuring data collection and research on violence against women and domestic violence', Article 11 of the Istanbul Convention. Strasbourg: Council of Europe Publishing, 2016.
- Dale, P. 'Delivering Justice to Sierra Leone's Poor. An Analysis of the Work of Timap for Justice'. Justice for the Poor research report. Washington, D.C.: World Bank, 2009.
- Dinnen, S. and N. Hailey. 'Evaluation of the community officer project in Solomon Islands'. Justice for the Poor research report. Washington, D.C.: World Bank, 2012.
- Dugard, J. and K. Drage. 'To Whom Do the People Take Their Issues? The Contribution of community-based paralegals to access to justice in South Africa'. Justice for the Poor research report. Washington, D.C.: World Bank, 2013.
- European Institute for Gender Equality. 'Mapping administrative data sources on gender-based violence in the EU-28: current status and potential'. Studies on gender-based violence, 2014.
- Franco, J., H. Soliman and M.R. Cisnero. 'Community based paralegalism in the Philippines'. Justice for the Poor research report. Washington, D.C.: World Bank, 2014.
- High-Level Panel of Eminent Persons on the Post-2015 Development Agenda. 'A new global partnership: eradicate poverty and transform economies through sustainable development'. Report of the High-Level Panel of Eminent Persons on the Post-2015 Development Agenda, New York: United Nations, 2013.
- Himelein, K., N. Menzies and M. Woolcock. 'Surveying justice: a practical guide to household surveys'. Justice and Development Working Paper Series. Washington, D.C.: World Bank, 2010.
- International Development Law Organization. 'Accessing justice: models, strategies and best practices on women's empowerment'. Rome: International Development Law Organization, 2013.
- 'Women's professional participation in Afghanistan's justice sector: challenges and opportunities'. Rome: International Development Law Organization, 2014.
- Jubb, N. and W.P. Izumino. 'Women and policing in Latin America. A revised background paper'. Paper presented at the meeting of the Latin American Studies Association in Dallas, Texas, 2 March 2003.
- Marchiori, T. 'Women's access to justice in Afghanistan'. Mimeo. Washington, D.C.: World Bank, 2014.

- Open Society Justice Initiative. Community-based paralegals: a practitioners' guide. New York: Open Society Foundations, 2010.
- Organization of American States 'Progress indicators for measuring the implementation of the Inter-American Convention on the Prevention, Punishment and Eradication of Violence against Women Belém do Pará Convention'. Washington, D.C.: Organization of American States, 2013.
- 'Guía práctica para la aplicación del sistema de indicadores de progreso para la medición de la implementación de la Convención de Belém do Pará'. Washington, D.C.: Organization of American States, 2015.
- Rule of Law Initiative. Access to justice assessment tool. Washington, D.C.: American Bar Association, 2012.
- Sumner, C., M. Zurstrassen and L. Lister. 'Increasing access to justice for women, the poor and those living in remote areas: an Indonesian case study'. Justice for the Poor Briefing Note, Volume 6, Issue 2. Washington, D.C.: World Bank, 2011.
- UN. 'Indicators to measure violence against women'. Report of the Expert Group Meeting. Geneva: United Nations, 2007.
- 'The road to dignity by 2030: ending poverty, transforming all lives and protecting the planet'. Synthesis report of the Secretary-General on the post-2015 sustainable development agenda., 2014. Available from <http://bit.ly/1XXqoKU>
Accessed 12 February 2016.
- UN DESA-DAW. Handbook for legislation on violence against women. New York: United Nations, 2009.
- UN Women. Progress of the world's women. In pursuit of justice. New York: UN Women, 2011.
- A transformative stand-alone goal on achieving gender equality, women's rights and women's empowerment: imperatives and key components. New York: UN Women, 2013.
- UN Women/UNICEF/UNDP. Informal justice systems. Charting a course for human-rights based engagement, 2009.
- UNDP. 'Access to justice'. Practice note, 2004. Available from <http://bit.ly/1Pu4NBq>
Accessed 12 February 2016.
- Programming for justice: access for all – A practitioner's guide to a human rights-based approach to access to justice. Bangkok: UNDP, 2005.
- Evaluation of UNDP's support to mobile courts in Sierra Leone, Democratic Republic of the Congo, and Somalia. New York: UNDP, 2014.
- UNODC. Accounting for security and justice in the post-2015 development agenda. New York: UNODC, 2013.
- Vetten, L., R. Jewkes, R. Sigsworth, N. Christofides, L. Loots and O. Dunseith. 'Tracking Justice: The Attrition of Rape Cases through the Krivično Justice System in Gauteng. Johannesburg: Tshwaranang Legal Advocacy Centre, the South African Medical Research Council and the Centre for the Study of Violence and Reconciliation, 2008. Available from <http://bit.ly/1UV1jJB>
Accessed 12 February 2016.
- World Bank. Engendering development – Through gender equality in rights, resources and voice. Washington, D.C.: World Bank, 2001.
- World Development Report 2012: gender equality and development. Washington, D.C.: World Bank, 2011.
- Women, Business and the Law 2014 – Removing restrictions to enhance gender equality. Washington, D.C.: World Bank, 2013.

SHËNIME FUNDORE

- 1 Nuk ka asnjë përkufizim të vetëm për qasjen në drejtësi. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) e përkufizon atë gjerësisht si "aftësia e njerëzve për të kërkuar dhe për të marrë një mjet juridik përmes institucioneve formale ose joformale të drejtësisë dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut", shih UNDP (2005). Sipas Rekomandimit të Përgjithshëm Nr.33 të Komitetit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e drejta e grave për qasje në drejtësi "përfshin dhënien e drejtësisë, disponueshmërinë, aksesueshmërinë, cilësinë e mirë dhe përgjegjshmërinë e sistemeve të drejtësisë dhe ofrimin e mjeteve juridike për viktimat", shih Komiteti CEDAW (2015).
- 2 Analiza e qasjes në drejtësi dhe elementeve të saj përbërëse e kryer në këtë raport mbështetet nga një qasje e bazuar te të drejtat, sipas të kuptuarit se njerëzit kanë të drejtë të marrin zgjidhje për ankesat e tyre nëpërmjet institucioneve të drejtësisë. Kundrejt këtij sfondi, ne identifikojmë elementët e zinxhirit të drejtësisë që janë kyç për një vlerësim të aksesueshmërisë së një sistemi drejtësie si hapat ose përbërësit e zinxhirit të drejtësisë që ndikojnë më shumë në aftësinë e njerëzve për të ushtruar këtë të drejtë. Këto elemente, kur mungojnë ose funksionojnë keq, janë identifikuar si barrierat kryesore për qasjen në drejtësi, ashtu si kur janë të krijuara dhe të zbatuara siç duhet, ato përbëjnë shembuj të praktikave më të mira që nxisin qasjen në sistemin e drejtësisë. Shih, për shembull, UNDP (2004); UN Women (2011); Banka Botërore (2011); Nisma për Shtetin e së Drejtës (2012).
- 3 Neni 2 i CEDAW krijon një detyrim për shtetet që të garantojnë "mbrojtjen efektive të grave ndaj çdo akti diskriminimi" gjithashtu nëpërmjet krijimit të "gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera shtetërore". Neni 15 parashikon që gratë dhe burrat janë të barabartë para ligjit. Në fund, një sërë rekomandimesh të përgjithshme të dhëna nga Komiteti CEDAW kanë interpretuar dispozitat e CEDAW-it për të detyruar më tej shtetet që të sigurojnë që "të gjitha gratë të kenë akses në edukim dhe informacion rreth të drejtave të tyre, në sisteme kompetente, me ndjeshmëri gjinore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe të drejta të barabarta për mjete juridike efektive", shih Komiteti CEDAW (2015).
- 4 Shih për shembull, UN Women (2012); Banka Botërore (2012); Këshilli i Europës (2014A); Këshilli i Europës (2014B); Komiteti CEDAW (2015); dhe UN Women/ UNICEF/UNDP (2009).
- 5 Një fushë e qasjes së grave në drejtësi që ka marrë më shumë vëmendje është ajo e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave. Për shembull, "Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për prodhimin e statistikave mbi dhunën ndaj grave: anketa statistikore", u ofron qeverive mjete për matjen dhe analizimin e të dhënave mbi dhunën ndaj grave; Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) mbledh të dhëna mbi drejtësinë penale, duke përfshirë dhunën ndaj grave. Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), nëpërmjet Mekanizmit zbatues të Konventës Belém do Pará jep udhëzime mbi zbatimin e konventës dhe po përgatit një sërë treguesish për të matur progresin kombëtar në lidhje me zbatimin e konventës. Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) vendos kërkesa të detyrueshme për shtetet që të mbledhin të dhëna për dhunën ndaj grave. Një mekanizëm monitorues do të vlerësojë zbatimin e konventës nga palët. Instituti Evropian për Barazinë Gjinore përgatiti një raport që mat statusin e mbledhjes së të dhënave administrative të shteteve mbi dhunën me bazë gjinore (Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, 2014), dhe thekson boshllëqet dhe mundësitë. Në vitin 2008, Këshilli i Europës publikoi raportin "Mbledhja e të dhënave administrative mbi dhunën në familje në Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës".
- 6 Shih Rezolutën e Kombeve të Bashkuara A/ RES/70/1, f. 1.
- 7 UN Women kishte bërë avokati për përfshirjen e një objekti të pavarur për barazinë gjinore, duke përfshirë synimin për qasjen e grave në drejtësi. Edhe pse agenda post-2015 për zhvillimin me formulimin e saj aktual përfshin një objektivi të tillë të pavarur (Objektivi 5), ai nuk përfshin një synim për të "rritur sigurinë, shërbimet mbështetëse dhe drejtësinë për gratë dhe vajzat" siç është mbrojtur nga UN Women (shih UN Women 2013). Ky synim i propozuar, i cili kishte për qëllim matjen e qasjes në drejtësi, ishte përfshirja e një treguesi që gjurmonte shprehimisht "përqindjen e profesionistëve të zbatimit të ligjit që janë gra (përfshirë gjyqtarët dhe policinë)".
- 8 Procesi i monitorimit do të fillojë në vitin 2016.
- 9 Paketa shtesë treguesish, përfshirë matjet e qasjes në drejtësi, të cilat nuk janë marrë në kampionim për këtë studim, janë, mes të tjerave: Raporti i Konkurrencës Globale; Raporti i Hendekut Gjinor Global; Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International; Raporti i Freedom House "Liria në botë"; Doing Business; Anketa e Vlerave në Botë; Anketat e grupeve me tregues të shumfishtë të UNICEF-it; Latinobarómetro. Lidhur me treguesit e përdorur nga qeveritë kombëtare, shumica e vendeve mbledhin të dhëna në lidhje me drejtësinë për stafin e gjykatave, fluksin e çështjeve dhe perceptimin e publikut për sigurinë dhe institucionet.
- 10 Treguesit SIGI të OECD-së mbështeten në profilet e vendeve të përgatitura nga ekspertë, si dhe në burime të ndryshme dytësore të të dhënave sasiore dhe cilësore (DHS, MICS, Treguesit e Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore, etj.). Profilet e shteteve përgatiten për çdo vend në indeksin SIGI, nga ekspertë të vendit duke u mbështetur në burimet dytësore të të dhënave dhe literaturën ekzistuese.
- 11 Duke pasur parasysh numrin e lartë të treguesve të grupuar nën këto "dimensione", ne nuk i përfshijmë ato në matricë: Për listën e plotë të treguesve, ju lutemi shikoni faqen e internetit të WBL në <http://wbl.worldbank.org/data/exploretopics/getting-a-job>, përdorur më 11 shkurt 2016.

- 12 Në fakt ky mund të quhet një meta-tregues; domethënë një tregues që gjurmon ekzistencën e mbledhjes së të dhënave për një fenomen të caktuar, në vend që të dhënat të kapin vetë fenomenin. Është përfshirë në listë pasi përgjigjet e shteteve japin informacion të vlefshëm nëse ata po mbledhin të dhënat e përmendura nga treguesi.
- 13 Dhuna seksuale përfshin dhunën ndaj grave të kryer nga partneri i tyre aktual. Shih Agjencia për të Drejtat Themelore (2012: 33 dhe ff).
- 14 Treguesit MESECVI nuk janë finalizuar dhe ende po zhvillohen diskutime mes shteteve anëtare për burimet e tyre të të dhënave. Megjithatë, treguesit e përfshirë në tabelën 2.5 KA shumë të ngjarë të bazohen në të dhënat administrative të mbledhura nga shtetet.
- 15 Konventa Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave, "Konveta Belém do Pará". Miratuar në Belém do Pará, Brazil, më 9 qershor 1994 dhe hyrë në fuqi më 5 mars 1995.
- 16 Ky tregues në vetvete nuk mbështetet në të dhëna administrative. Megjithatë, përgjigjet e shteteve japin informacion të vlefshëm nëse ato po mbledhin të dhënat e përmendura aty.
- 17 Ky dhe disa nga treguesit e mëposhtëm, siç u theksua në shënimin fundor më sipër, përmenden këtu pasi përgjigjet e shteteve përkatëse japin informacion se cilat statistika të lidhura me drejtësinë po mbledhin shtetet.
- 18 G7+ është një shoqatë vullnetare e vendeve që janë ose janë prekur nga konflikti dhe tani janë në tranzicion në fazën tjetër të zhvillimit. Objektivi kryesor i g7+ është të ndajë përvoja dhe të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të bëjnë avokati për reformat në mënyrën se si komuniteti ndërkombëtar angazhohet në shtetet e prekura nga konflikti. Për të mësuar më shumë rreth g7+ vizitoni www.g7plus.org.
- 19 Procesi i monitorimit do të fillojë në vitin 2016.
- 20 Shih edhe Këshilli i Europës (2016).
- 21 Afrobarometri, UNROLI dhe disa nga anketa të standardit të jetesës janë ndër burimet që përfshijnë tregues nga pala kërkuese e drejtësisë. Për shembull, Anketa e Standardeve të Jetesës në Ganë (raundi 6), Anketa Kombëtare për Kushtet e Jetesës në Guatemalë (2000) dhe Anketa e Zgjeruar për Kushtet e Jetesës në Timor-Leste (2008) përmbajnë pyetje mbi konfliktet kryesore të përjetuara në komunitet ose drejtpërdrejt nga të anketuarit ose nga anëtarët e familjeve të tyre. Anketa e zgjeruar për Kushtet e Jetesës në Timor-Leste përmban gjithashtu pyetje të detajuara mbi atë që bënë të anketuarit të cilët përjetuan një mosmarrëveshje dhe arsyen pse. Gjithashtu, Anketa e Standardeve të Jetesës në Ganë, Anketa e Zgjeruar e Kushteve të Jetesës në Timor-Leste, Afrobarometri dhe UNROLI përmbajnë pyetje mbi besimin e të anketuarve në institucionet e drejtësisë.
- 22 Shih, për shembull, Nisma për Shtetin e së Drejtës (2012); Këshilli i Europës (2013); Komiteti CEDAW (2015).
- 23 Një tregues mbi "njohurinë e publikut për mekanizmat kryesorë në dispozicion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" përdoret, për shembull, në Anketën e Standardeve të Jetesës në Gana.
- 24 Tabela 2.1. në seksionin e mëparshëm jep shembuj të treguesve që matin aksesin fizik. Paketa e WJP përfshin një tregues për vendndodhjen e gjykatës, ndërsa Global Integrity pyet ekspertët nëse të gjithë qytetarët kanë akses në gjykata "pavarësisht vendndodhjes gjeografike". CEPEJ monitoron numrin dhe vendndodhjen e gjykatave.
- 25 Termi "ndihmë juridike" përfshin, për qëllimet e formulimit të këtij treguesi, avokatët dhe jo avokatët, që ofrojnë këshilla ligjore, ndihmë ose përfaqësim, pavarësisht nëse janë apo jo pjesë e programeve shtetërore të ndihmës juridike dhe nëse janë apo jo financuar nga shteti, si edhe fuqizimin ligjor.
- 26 Ndërsa ofrimi i ndihmës dhe përfaqësimit ligjor falas ose i subvencionuar sigurisht ul barrierat ekonomike për qasjen në drejtësi, tarifën gjyqësore mund të jenë ende penguese për një pjesë të madhe të atyre që kërkojnë drejtësi dhe, në veçanti, për gratë me aftësi të kufizuara ose që nuk kanë mundësi autonome të përdorin burimet ekonomike, p.sh., kategoritë e pafavorizuara si gratë kryefamiljare, ato që kërkojnë detyrim ushqimor pas një divorci ose ato që i largohen një situatë të dhunës në familje. Në Kamboxhia, tarifat për ekzaminimet mjeko-ligjore në rastet e përdhunimeve ishin të barabarta me të ardhurat mesatare për rreth dy javë në zonat rurale (të dhëna të vitit 2007); në Indonezi, ku kostoja mesatare e një divorci ishte rreth 10 herë më e madhe se të ardhurat mujore të një gruaje të varfër, heqja e tarifave ndihmoi në rritjen e aksesit të grave në gjykata dhe përfitimet e ofruara nga shteti. Shih UN Women (2011: 54); Banka Botërore (2011: 168, 367); Chiongson et al. (2011).
- 27 Shih Komiteti CEDAW (2015: 8), i cili përfshinte mes rekomandimeve të tij për aksesueshmërinë "krijimin e njësisve gjinore si përbërës të institucioneve të drejtësisë".
- 28 Anketa për dhunën ndaj grave në Bashkimin Europian, e publikuar në mars 2014, tregoi se vetëm 14% e ngjarjeve më të rënda të dhunës nga partneri ishin denoncuar në polici (dhe 13% në rastin e dhunës jo nga partneri), FRA (2014).
- 29 Pushimi është një fenomen i shumëanshëm që përfshin aspekte si të palës kërkuese së drejtësisë, siç janë presionet sociale ose frika nga hakmarrja, ashtu edhe të palës ofruese, siç janë procedurat e gjata dhe të kushtueshme. Në zgjedhjen ta përfshinin atë në dimensionin e palës kërkuese të drejtësisë sepse ka aspekte të pushimit të rasteve me interes të veçantë për një analizë gjinore të qasjes në drejtësi.
- 30 Të dhënat nga Provinca Gauteng, Afrika e Jugut, tregojnë se vetëm 17% e rasteve të denoncimeve të përdhunimeve kanë shkuar në gjykatë dhe vetëm 4% kanë rezultuar me dënim. Shih UN Women (2012: 49); Vetten et al. (2008); Këshilli i Europës (2013: 12).
- 31 Për shkak se besimi është një element në thelb subjektiv, i cili mund të pasqyrojë interpretimet individuale të fakteve, paketa e treguesve duhet të përdoret për të krijuar një kontekst për analizë të

- saktë të të dhënave. Anketa e përdoruesit ose të dhënat administrative mund t'i shërbejnë qëllimit: për shembull, pyetja e përdoruesve të gjykatës sa shpesh ju është kërkuar të paguajnë ryshfet për të vënë në lëvizje procesin ose për të marrë rezultatin e dëshiruar, është e dobishme për të kontekstualizuar perceptimin e përgjithshëm të korrupsionit në gjyqësor.
- 32 Ky tregues përfshihet në versionin më të fundit të "Treguesit me prioritet për Objektivin 16" të propozuar nga Ekipi i Mbështetjes Teknike për agjendën post-2015 për zhvillimin.
- 33 Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e praktikave të mira u përgatit nga Këshilli i Europës dhe u botua në tetor 2015. Përmbledhja përfshin 65 hyrje nga 24 shtete anëtare të Këshillit të Europës dhe e gjeni në www.coe.int/equality, përdorur më 12 shkurt 2016.
- 34 Shih Dinnen S. dhe Hailey N (2012); Nisma e Shoqërisë së Hapur për Drejtësi (2010); Dale P. (2009); Berenschot W. dhe Rinaldi T. (2011); Instituti i Shoqërisë së Hapur dhe PNUD; Dugard J. dhe Drage K. (2013); Franco J., Soliman H. dhe Cisnero M. (2014).
- 35 Shihni "Edukimi global që fuqizon gratë në Papua Guinea e Re", Sekretariati i Gjykatave të Fshatit dhe Ndërmjetësimin për Tokën në Papua Guinean e Re, studim i pabotuar mbi gjyqtaret femra në Papua Guinea e Re, e gjeni në www.globaleducation.edu.au/case-studies/empowering-women-in-png.html, përdorur më 12 Feb 2016.
- 36 UN Women (2011: 59). Një ANKETË e vitit 2010 TREGON që 85% e grave të anketuara e dinin të drejtën e tyre për t'u divorcuar dhe kishin dijeni që mund ta ushtronin përmes pjesëve të posaçme të legjisllacionit familjar (krijuar më 2004).
- 37 Prokurorët e specializuar mund të ulin pengesat ndaj drejtësisë, e gjeni në www.endvawnow.org/en/articles/894-specialized-prosecutors-can-reduce-barriers-to-justice.html?neXT=895, përdorur më 12 shkurt 2016.

UN WOMEN ËSHTË ORGANIZATA E OKB-SË DEDIKUAR BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMIT TË GRAVE. KAMPIONI GLOBAL PËR GRATË DHE VAJZAT, UN WOMEN U KRIJUA PËR TË PËRSHPEJTUAR PROGRESIN PËR PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË TYRE NË MBARË BOTËN.

UN Women mbështet Shtetet Anëtare të OKB-së teksa ato vendosin standarde globale për arritjen e barazisë gjinore dhe punon me qeveritë dhe shoqërinë civile për hartimin e ligjeve, politikave, programeve dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të zbatuar këto standarde. UN Women qëndron pas pjesëmarrjes së barabartë të grave në të gjitha aspektet e jetës, duke u fokusuar në pesë fusha prioritare: rritja e udhëheqjes dhe pjesëmarrjes së grave; dhënia fund e dhunës ndaj grave; angazhimi i grave në të gjitha aspektet e proceseve të paqes dhe sigurisë; rritja e fuqizimit ekonomik të grave; dhe vendosja e barazisë gjinore në qendër të planifikimit dhe buxhetimit për zhvillimin kombëtar. Gjithashtu UN Women koordinon dhe promovon punën e sistemit të OKB-së në avancimin e barazisë gjinore.

Përkthimi është bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



220 East 42nd Street
New York, New York 10017, USA
Tel: 212-906-6400
Fax: 212-906-6705

Ky përkthim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

www.unwomen.org
www.facebook.com/unwomen
www.twitter.com/un_women
www.youtube.com/unwomen
www.flickr.com/unwomen
www.instagram.com/unwomen